



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 448 Akti

Nr. 445 Vendimi  
Tiranë, më 16.9.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Xhensila Pine</b>	Kryesuese
<b>Olsi Komici</b>	Relator
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në Tiranë, në datën 13.9.2021 ora 9:50, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Arben Nika**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Arben Nika, vëzhguesen ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Arben Nika, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit Arben Nika, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit u shortua me shortin e datës 16.12.2019 dhe do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët, Xhensila Pine, Valbona Sanxhaktari dhe Olsi Komici. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Olsi Komici.

3. Me vendimin nr. 1, datë 23.1.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e subjektit Arben Nika, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale. Si kryesuese e trupit gjykues, u caktua komisionere Xhensila Pine.

4. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Subjekti deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupës.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Elka Ermenkova.

5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim, Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, DSIK) dhe Grupi i Punës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

6. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështje në datën 30.7.2021, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Arben Nika, si dhe njoftimin tij për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

**8.** Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 30.7.2021, mbi përbërjen e trupit gjykues, rezultatet e hetimit, si dhe mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht zhvilluar nga Komisioni.

**9.** Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe dosjen në datën 23.8.2021, ka dërguar nëpërmjet postës elektronike në Komision prapësimet dhe provat për rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni.

**10.** Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike nga Komisioni në datën 2.9.2021, ora 10:00, për seancën dëgjimore që do të zhvillohej më 13.9.2021, ora 10:00.

**11.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, datë 13.9.2021, ora 10:00, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova.

**12.** Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe parashtroi shpjegimet e tij. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit Arben Nika, kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**13.** Z. Arben Nika ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

## **III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**14.** Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie*, në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

**15.** Për subjektin e rivlerësimit Arben Nika, bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

**16.** Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## A. VLERËSIMI I PASURISË

### A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

**17. ILDKPKI-ja<sup>1</sup>**, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Arben Nika, i cili është subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së që prej vitit 2003, me numër indeksi \*\*\*, duke konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

### A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

**18.** Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.

**19.** Subjekti i rivlerësimit Arben Nika, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, datë 26.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë - shtojca 2 (deklarata *Vetting*), janë si vijojnë:

#### **1. Apartament banimi me sip. 107.33 m<sup>2</sup> dhe 13.8 m<sup>2</sup> sipërfaqe e përbashkët**

Pasuria e sipërcituar është me vendndodhje në rrugën “\*\*\*\*”, zona e F., Tiranë, blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 16.7.2014<sup>2</sup>. Vlera: 51,000 euro (e konvertuar në lekë sipas kontratës 7,140,000 lekë). Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: kursimet e subjektit dhe të bashkëshortes ndër vite; kredi e marrë në BKT për blerje apartamenti, sipas kontratës së kredisë, datë 26.7.2011<sup>3</sup>, në shumën 2,580,000 lekë.

**1.1** Subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën e interesave private periodike të vitit 2011 (DIPP në vijim) me të njëjtat të dhëna dhe burime si në deklaratën *Vetting*.

**1.2** Komisioni ka administruar përgjigjen e notere V.S.<sup>4</sup>, e cila ka përcjellë pranë Komisionit kontratat si vijon:

i) Kontratë porosie, datë 14.7.2011<sup>5</sup>, me sipërmarrës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe porositës shtetasin L.B., për apartamentin me sip. 121.2 m<sup>2</sup>, k. \*\*\*, seksioni \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, Q., Tiranë dhe apartamentin me sip. 75.79 m<sup>2</sup> (sipërfaqet e apartamenteve përfshijnë edhe sipërfaqet e

<sup>1</sup>Raporti nr. \*\*\* prot., datë 13.12.2018, i ILDKPKI-së.

<sup>2</sup>Regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*f. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*.

<sup>3</sup>Kontrata e kredisë nr. \*\*\*, datë 26.7.2011.

<sup>4</sup>Përgjigja e datës 25.2.2021, e notere V. S.

<sup>5</sup>Kontratë porosie nr. \*\*\*, e datës 14.7.2011.

përbashkëta), k. \*\*\*, seksioni \*\*\*, për vlerën totale 88,645 euro, shumë e likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale.

ii) Kontratë premtim-shitje, datë 14.7.2011<sup>6</sup>, me shitës shtetasin L.B. dhe blerës shtetasit L. dhe Arben Nika dhe dhënës pëlqimi shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. për apartamentin me sip. 121.2 m<sup>2</sup>. Objekti i kësaj kontrate është heqja dorë e shtetasit L.B. nga të drejtat që lindin nga kontrata e porosisë nr. \*\*\*, datë 14.7.2021, vetëm për apartamentin me sip.121.2 m<sup>2</sup> dhe dorëzimi nga prej tij në favor të shtetasve L. dhe Arben Nika, të këtij apartamenti me çmimin 420 euro/m<sup>2</sup> dhe vlerë totale 51,000 euro sipas kësteve:

kësti I = 30,000 euro likuiduar jashtë zyrës noteriale;

kësti II = 18,500 euro do të likuidohet me kredi bankare, por jo më vonë se data 31.8.2011;

kësti III = 2,500 euro do të likuidohet me nënshkrimin e aktit përfundimtar të shitjes.

iii) Kontratë shitblerjeje, datë 16.7.2011<sup>7</sup>, me shitës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe blerës shtetasit L. dhe Arben Nika, për apartamentin me sip. 121.13 m<sup>2</sup> (107.33 m<sup>2</sup>+ 13.8 m<sup>2</sup> sipërfaqeje të përbashkëta), k. \*\*\*, ap. \*\*\*, shk. \*\*\*, L., Tiranë, me çmimin 51,000 euro = 7,140,000 lekë. Kjo shumë është likuiduar sipas kontratës premtim shitje nr. \*\*\*, datë 14.7.2011.

**1.3** ASHK-ja Rurale 1, Tiranë<sup>8</sup> konfirmon regjistrimin në emër të shtetasve Arben dhe A.N. të pasurisë “apartament” me sip. 107.33 m<sup>2</sup> me adresë L., Tiranë. Apartamenti, sipas kontratës së shitjes, datë 16.7.2011, është regjistruar fillimisht në emër të shtetasve L. dhe Arben Nika. Me deklaratën noteriale të datës 24.2.2018<sup>9</sup>, shtetasi L.N. deklaroi se heq dorë nga pjesa e tij takuese në këtë apartament në favor të djalit të tij Arben L. Nika dhe nuses së djalit A.Sh.N. pa shpërblim.

**1.4** Subjektit i është kërkuar<sup>10</sup> të provojë me dokumentacion ligjor pagesat e bëra për apartamentin në vlerën 51,000 euro duke identifikuar për çdo pagesë burimin e ligjshëm të krijimit, i cili ka shpjeguar se: *“Një pjesë e pagesës së apartamentit është kryer nëpërmjet llogarive bankare të pasqyruara në vijim dhe pjesa tjetër është paguar cash. Burimi i këtyre pagesave janë depozitat bankare të krijuara ndër vite nga të ardhurat nga punësimi dhe kredi e marrë në shumën 2,580,000 lekë pranë BKT. Kjo kredi pasi është disbursuar, është tërhequr dhe konvertuar në euro dhe më pas është kaluar në shumën 19,000 euro në llogari të përfituesit L.B. Pagesat në fjalë janë kryer nëpërmjet llogarive bankare [...] 10,000 euro datë 26.4.2011; 9135 euro datë 13.5.2011; 865 euro datë 17.5.2011; 1000 euro datë 1.11.2011; 5000 euro (debituar llogaria në vlerën 684,000 lekë) datë 5.12.2011 ndërkohë që vlera 6000 euro është paguar cash”*.

**1.5** Komisioni ka kërkuar nga subjekti të specifikojë kohën e kryerjes së pagesës cash për vlerën 6,000 euro, si dhe të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të saj. Subjekti ka shpjeguar se: *“Në shpjegimet e mia në pyetësonin nr. 2, jam shprehur gabim lidhur me kështet e pagimit të shtëpisë.[...] Gabimi qëndron se debitimi i llogarisë në vlerën 684,000 lekë, kredituar 5,000 euro, është kryer për llogari të prindërve të bashkëshortes sime për banesën e prenotuar nga*

<sup>6</sup>Kontratë premtim-shitje nr. \*\*\*, datë 14.7.2011.

<sup>7</sup>Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 16.7.2011.

<sup>8</sup>ASHK-Zyra Vendore Rurale 1 me nr. \*\*\* prot., datë 29.4.2020.

<sup>9</sup>Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 24.2.2018.

<sup>10</sup>Shihni pyetësonin nr. 2.

*ana e tyre...tek i njëjti shtetas z. L.B. [...] Gjatë vitit 2011..., për shkak se kursimet tona kanë qenë të investuar në USD (gjendje në llogarinë në USD të bashkëshortes), të cilat për shkak të ndryshimit të kursit të shitjes së USD, i cili ishte shumë më i ulët se kursi i blerjes së tyre, na pengonte përdorimin për të mos patur humbje nga këmbimi valutor, u desh të huazonim përkohësisht nga nëna e bashkëshortes dhe ime motër. [...] Në dijeni të këtij fakti, jam vënë pas diskutimit me vjehrrën ku kam kërkuar nëse kujtohej për datën e kthimit në cash, e cila më konfirmoi që nuk ja kemi kthyer në cash por kemi kryer pagesën për shlyerje kësti për llogari të saj dhe vetëm një pjesë të saj shumë prej 792 euro i kemi dhënë cash”.*

**1.6** Komisioni ka analizuar çmimin e blerjes së apartamentit krahasuar me çmimet referuese të EKB-së për vitin 2011, ku sipas udhëzimit të vitit 2011<sup>11</sup> vlera mesatare e shitblerjeve të banesave në tregun e lirë për qytetin e Tiranës në zonën 3/1 ku përfshihet edhe zona e F. është 67,000 lekë/m<sup>2</sup>. Duke llogaritur 121.13 m<sup>2</sup> x 67,000 lekë = 8,115,710 lekë ose 58,349 euro (sipas kursit ditor të llogaritur 139.09 lekë/euro). Rezulton një diferencë prej 7,349 euro ndërmjet çmimit të blerjes në kontratë me çmimin referues të EKB-së.

**1.7** Subjekti i rivlerësimit është pyetur për diferencën në çmimin e blerjes së apartamentit në datën 14.7.2011 me çmimin 420 euro/m<sup>2</sup> nga shitësi L.B., ndërkohë që në po të njëjtën datë shtetasi L.B. e kishte blerë këtë apartament nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. me çmimin 450 euro/m<sup>2</sup>, i cili ka shpjeguar se: “...nuk kam pasur dijeni dhe interes mbi marrëdhënien financiare që pala shitëse L.B. dhe ndërtuesi P.M. - \*\*\* kanë pasur me njëri-tjetrin, si dhe çmimet referuese. Apartamenti na është relatuar nga ana e z. B. në cilësinë e nënkontraktorit (si pjesë e pjesëve të akorduara këtij të fundit referuar marrëveshjes se kleringut). Që në krye të herës të gjithë komunikimet dhe marrëdhëniet financiare në lidhje me këtë pronë kanë qenë vetëm me Z. B. [...]”.

**1.7.1** Nga të dhënat në faqen zyrtare të QKB-së konfirmohet se z. L.B. është regjistruar si person fizik me NIPT \*\*\* me objekt “shërbime të ndryshme ndërtimi”, me adresë në L., Dajt. Komisioni vëren se referuar deklarimeve të subjektit dhe kontratave mbi apartamentet, shpjegohet marrëdhënia e kleringut midis shtetasit L.B. dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**1.8** Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetasve L.B., P.M. dhe D.M.<sup>12/13</sup> dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

**Analizë e burimeve financiare të përdorura për blerjen e pasurisë “apartament”, me sip. 107.33 m<sup>2</sup>, në shumë 51,000 euro, në zonën e F., Tiranë**

**1.9** Në analizë të të dhënave dhe informacionit të rezultuar nga llogaritë bankare të subjektit dhe bashkëshortes, si dhe mbështetur në deklarimet e subjektit në pyetësor nr. 3, është hartuar analiza financiare për secilin prej kësteve të apartamentit.

***Kësti I - shlyer në datën 16.4.2011, pagesa cash, në vlerën 10,000 euro***

<sup>11</sup>Udhëzimi nr. 4, datë 23.11.2011, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2011”.

<sup>12</sup>P. M. dhe D.M. administatorë dhe ortakë të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

<sup>13</sup>Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe Dibër, përkatësisht me nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2021.

**1.9.1** Subjekti, gjatë procesit të rivlerësimit, deklaroi<sup>14</sup> se burimet *cash* janë tërhequr nga BKT-ja, si dhe sqaron se në datën 12.1.2011, nga llogaria e bashkëshortes në BKT është tërhequr vlera 7,000 euro, por nuk përcjell informacion mbi diferencën prej 3,000 euro për plotësimin e këtij kësti.

**1.9.1.1** Nga BKT-ja është konfirmuar vlera 7,000 euro e tërhequr nga bashkëshortja e subjektit, nga ku dhe rezultoi se kjo vlerë është krijuar prej vlerës 5,248.71 euro të transferuar në datën 12.1.2011 dhe depozitimit *cash* të vlerës 1,800 euro në datën 11.1.2011. Depozita që ka shërbyer si burim i pjesshëm për krijimin e vlerës 7,000 euro, është krijuar në datën 11.5.2010 dhe veprimet në këtë llogari depozite janë paraqitur në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 1**

<i>Tërheqje në euro</i>	<i>Derdhje në euro</i>	<i>Sqarime</i>
	3 200	Transfertë nga llog. ***
	500	Transfertë nga llog. e bashkëshortes
	600	Transfertë nga llog. e bashkëshortes
100	1 000	Derdhje <i>cash</i>
270	270	Derdhje <i>cash</i>
475	475	Derdhje <i>cash</i>
<b>845</b>	<b>6 045</b>	<b>Totali 5,200 euro</b>

**1.9.1.2** Komisioni, nga hetimi i llogarive bankare të subjektit, konstaton se në datën 16.1.2012 është bërë transfertë në vlerën 54,800 lekë nga llogaria e bashkëshortes te shtetasi L.B. me përshkrimin “A. A. sa kaluar diferencë kësti”. Rezultoi se subjekti nuk e ka deklaruar këtë pagesë si këst i paguar për blerjen e apartamentit në DIP-të për vitet 2011– 2016.

***Kësti II - shlyer në datën 26.4.2011, në vlerën 10,000 euro***

**1.9.2** Pagesa është bërë me transfertë bankare nga llogaria e bashkëshortes së subjektit A.N. (A.) në BKT<sup>15</sup> drejt llogarisë së z. L.B. me përshkrimin “likuidim kësti i tretë për blerje apartamenti te zona e F.”. Rezultoi se në të njëjtën datë (26.4.2011) është bërë transfertë në llogarinë e saj vlera 10,792 euro nga znj. N.Xh.A. (nëna e bashkëshortes) me përshkrim “dhënie huaje për blerje apartamenti”.

**1.9.2.1** Kthimi i huas te znj. N.A. është bërë në datën 26.12.2011 nga llogaria e bashkëshortes së subjektit në vlerën 5,000 euro me burim të ardhurat nga paga në lekë. Ndërsa diferenca e vlerës prej 5,792 euro deklarohet<sup>16</sup> me pyetësin nr. 2, se është shlyer *cash* brenda të njëjtit vit.

**1.9.2.2** Me pyetësin nr. 3 subjekti shpjegon se: “[...] Kjo hua është kthyer në datën 26.12.2011 në shumën 5,000 euro nënës së bashkëshortes dhe shuma prej 5000 euro e transaksionit të kryer nëpërmjet llogarisë me nr. \*\*\* me referencë \*\*\*, datë 5.12.2011, shumë 5,000 euro (debituar llogaria në vlerën 684,000 lekë-kredituar 5,000euro, është kryer për llogari të saj nga

<sup>14</sup>Shihni pyetësin nr. 3.

<sup>15</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2020, nga BKT-ja.

<sup>16</sup>Përgjigjja nr. 23, pyetësor nr. 2, “Si shpjeguar më sipër vlera prej 5,000 euro i është kthyer në llogari znj. N.A. me datë 26.12.2011, nëpërmjet veprimit me referencë ..., të kryer nga llogaria e bashkëshortes me nr... ndërkohë që pjesa tjetër është paguar *cash* brenda të njëjtit vit”.

*bashkëshortja ime si pjesë e huas që ne i detyroheshim. Diferenca prej 792 euro i është dhënë cash”.*

**1.9.2.3** Nga subjekti është shpjeguar <sup>17</sup> se shuma prej 5,000 euro e pagesës së datës 5.12.2011, të cilën subjekti e kishte deklaruar si pagesë për apartamentin e tij nga llogaria e A.N. te llogaria e L.B., në fakt është pagesë e kryer për llogari të prindërve të bashkëshortes dhe jo për apartamentin.

**1.9.2.4** Lidhur me burimin e krijimit të vlerës së huas së dhënë nga znj. N.A., Komisioni me pyetësin nr. 2 ka kërkuar nga subjekti që të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të shumës të dhënë hua për saj.

**1.9.2.5** Subjekti ka shpjeguar se: “[...] janë të ardhura të kursyera ndër vite si të ardhura nga pagat, investime, etj.”, por nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor.

### ***Kësti III - shlyer në datën 13.5.2011, në vlerën 9,135 euro***

**1.9.3** Pagesa është bërë me transfertë bankare në BKT, nga llogaria e bashkëshortes drejt llogarisë së z. L.B. me përshkrimin “likuidim detyrimi për blerje apartamenti”. Kjo shumë rrjedh nga këmbimi i vlerës 1,300,000 lekë të transferuar në këtë datë, në llogarinë të znj. N.A., nga znj. V.H. (motra e subjektit) me përshkrim “hua për blerje apartamenti”.

**1.9.3.1** Rezulton se kthimi i huas te znj. V.H. është bërë nëpërmjet llogarive bankare në BKT, me dy pagesa në shumat 1,000,000 lekë dhe 300,000 lekë, në datën 30.12.2011. Si burim për shlyerjen e kësaj huaje ka shërbyer maturimi i depozitës së bashkëshortes në datën 5.12.2011, në shumën 2,804,241 lekë.

**1.9.3.2** Komisioni, me pyetësin nr. 2, ka kërkuar nga subjekti që të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua nga znj. V.H., i cili ka shpjeguar se: “[...] janë të ardhura të kursyera ndër vite si të ardhura nga pagat, investime, etj.”, por nuk ka paraqitur dokumente provuese.

**1.9.3.3** Nga hetimi i llogarive në BKT rezulton se bashkëshortja e subjektit ka transferuar shumën 29,500 USD, në datën 9.6.2011, në llogarinë e deklaruar më sipër. Vlera e transferuar është mbyllur si depozitë 3-mujore dhe është maturuar në datën 12.9.2011, në vlerën 29,579 USD (përfshirë interesat e akumuluar), ku, më tej, brenda ditës është konvertuar nga bashkëshortja në vlerën 3,040,765 lekë. Gjithashtu, konstatohet se vlera e depozitës së mësipërme prej 29,500 USD e hapur në datën 9.6.2011 është krijuar nga transferimi i kësaj vlere nga llogaria rrjedhëse në dollarë e bashkëshortes në po atë datë. Ndërsa gjendja e llogarisë rrjedhëse në dollarë<sup>18</sup> është krijuar nga këmbimi i vlerës 3,040,765 lekë, datë 21.1.2011.

**1.9.3.4** Duke iu referuar të dhënave të Bankës së Shqipërisë rezulton se kursi i këmbimit USD/lekë në datën e pagesës së këstit të parë (më 26.4.2011) ka qenë 96.97 lekë, në datën e mbylljes së depozitës ( më 12.9.2011) ka qenë 103.58 lekë , ndërsa në datën e konvertimit të gjendjes së parave nga lekë/USD, datë 21.1.2011, kursi ka qenë 102,6 leka, pra, në datën e pagesës së këstit të parë, vlera e kursit të këmbimit ka qenë më e ulët se në datën e konvertimit të fondeve.

---

<sup>17</sup>Shihni pyetësin nr. 3.

<sup>18</sup>Llogaria bankare nr. \*\*\*.



Deklarimi i subjektit përputhet me të dhënat mbi kursin e këmbimit të rezultuar nga të dhënat e Bankës së Shqipërisë.

#### ***Kësti IV - shlyer në datën 17.5.2011, në vlerën 865 euro***

**1.9.4** Pagesa është bërë me transfertë bankare në BKT, nga llogaria e bashkëshortes drejt llogarisë së z. L.B. me përshkrimin “sa kaluar diferencë për pagesën për blerje apartamenti Arben Nika, datë 13.5.2011, shuma 9,135 euro”. Si burim i kësaj vlerë ka shërbyer huaja e dhënë nga znj. N.A. në datën 26.4.2011 dhe duket se kjo pagesë është sistemim dhe shtesë e kështit të dytë (trajtuar në pikën 1.9.2) të shlyer vetëm 5 ditë më herët (më 13.5.2011).<sup>19</sup>

#### ***Kësti V- shlyer në datën 17.8.2011, në vlerën 19,000 euro***

**1.9.5** Pagesa është bërë me transfertë bankare në BKT, nga llogaria e babait të subjektit, z. L.N., drejt llogarisë së z. L.B. me përshkrimin “L.N.N. për L.R.B., likuidim këst për blerje apartamenti (Arben + A.), shuma 19,000 euro”.

**1.9.5.1** Subjekti deklaron në deklaratën *Vetting* se si burim për krijimin e pasurisë së mësipërme kanë shërbyer të ardhurat nga kredia me kushte lehtësuese, e marrë në BKT, në shumën 2,580,000 lekë, sipas kontratës së kredisë nr. \*\*\*, datë 26.7.2011.

**1.9.5.2** Nga BKT-ja<sup>20</sup> konfirmohet disbursimi i kredisë në shumën prej 2,580,000 lekësh në llogarinë bankare të shtetasit L.N. në datën 28.7.2011. Nga veprimet bankare rezulton se kredia është tërhequr *cash* nga shtetasi L.N. në datën 1.8.2011, në shumën 1,390,000 lekë ose 9,964 euro (sipas kursit ditor të llogaritur 139.5 lekë/euro) dhe në datën 2.8.2011 në shumën 1,179,600 lekë ose 8,457 euro (sipas kursit ditor të llogaritur 139.48 lekë/euro), pra, në total shumën 2,569,600 lekë ose 18,500 euro.

**1.9.5.3** Në llogarinë bankare në monedhën euro të shtetasit L.N. janë kryer: (i) depozitimi *cash* i shumës 10,000 euro, më 1.8.2011, nga z. L.N. dhe depozitimi i shumës 6,000 euro, më 2.8.2011 i; (ii) depozitimi *cash* i shumës 3,000 euro, më 16.8.2011, nga znj. A.N.; (iii) kalimin e shumës 19,000 euro, më 17.8.2011, për znj. L.B., për likuidim kësti për blerje apartamenti.

**1.9.5.4** Subjekti është pyetur me pyetësor nr. 3, për të provuar burimin e ligjshëm të vlerës së derdhur *cash* prej 3,000 euro, depozitim nga znj. A.A., për të cilën shpjegon se: “[...] *Një pjesë e veprimeve të mësipërme janë kryer nga ana e bashkëshortes duke qenë se kjo e fundit asokohe ishte punonjëse pranë BKT-Dega Peshkopi, përfshirë dhe depozitimim e shumës 3,000 euro, e cila ka si burim të ardhura nga kredia e mësipërme si dhe një diferencë e plotësuar me të ardhurat nga punësimi (sipas transaksionit tërheqje cash në vlerën 70,000 lekë nga llogaria personale me nr. ..., ref. veprimi ..., 16-AUG-11 70,000)*”. Nga përgjigjja e BKT-së konfirmohen shpjegimet e mësipërme të subjektit.

#### ***Kësti VI - shlyer në datën 1.11.2011, në vlerën 1,000 euro***

**1.9.6** Subjekti deklaron se: “[...] *kësti i gjashtë i paguar me referencë ..., datë 1.11.2011, shumë 1,000 euro*”. Rezulton se pagesa është bërë me transfertë bankare në BKT, nga llogaria e

<sup>19</sup>Pasi është kryer pagesa e kështit të parë në datën 26.4.2011 me burim huan e vjehrrës së subjektit, nga vlera e mbetur prej 865 euro është tërhequr nga bashkëshortja vlera 750 euro dhe në datën e pagesës së kështit të dytë (datë 13.5.2011) është derdhur në llogarinë e saj përsëri kjo vlerë, por duket se gabimisht nuk është transferuar e gjithë vlera gjendje në atë ditë prej 10,000 euro, por pjesërisht (shuma 9,135 euro) nga ku diferenca (865 euro) është kaluar pas 5 ditësh, në datën 17.5.2011.

<sup>20</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2020, nga BKT-ja.

bashkëshortes së subjektit A.N. në datën 1.11.2011, ku si burim ka shërbyer derdhja *cash* në vlerën 200 euro nga shtetasi H.B. në datën 19.9.2011 dhe derdhja *cash* në vlerën 800 euro, në datën 5.10.2011.

**1.9.6.1** Subjekti është pyetur të shpjegojë lidhjen që ka me shtetasin H.B. dhe burimin e ligjshëm të derdhjes së bërë nga ky shtetas në llogari të bashkëshortes. Subjekti ka shpjeguar se shtetasi H.B. është ish-punonjës i BKT-së (mik i tyre) dhe veprimi i depozitimit është bërë me porosi të bashkëshortes. Pagesa prej 1,000 euro e bërë nga bashkëshortja ka si burim kursimet ndër vite.

Duke konsideruar se burimi i derdhjes *cash* nga bashkëshortja e subjektit janë kursimet nga të ardhurat nga paga, Komisioni hartoi analizën e mëposhtme financiare për të hetuar mundësinë e kryerjes së pagesës.

**Tabela nr. 2**

	<b>Përshkrim</b>	<b>Vlera në lekë</b>
<b>A</b>	<b><i>Të ardhura</i></b>	<b>6 628 146</b>
1	Likuiditete në bankë 01.01.2011	4 845 378
2	Të ardhura nga paga e subjektit 01.11.2011	889 792
3	Të ardhura nga paga e b/sh subjektit 01.11.2011	892 977
<b>B</b>	<b><i>Detyrime</i></b>	<b>2 538 120</b>
1	Kredi prane BKT sha date 26.07.2011.	2 538 120
<b>C</b>	<b><i>Shpenzime</i></b>	<b>1 255 485</b>
1	Shpenzime jetike 01.01.2011-01.11.11	455 400
2	Shpenzime qiraje	80 000
3	Shpenzime interesi	43 054
4	Shpenzime udhëtimi në funksion të detyrës (2010-2016)	237 130
5	Shuma të derdhura në llog. bankare të bashkëshortes nga persona të tretë, të konsideruara si shpenzime	439 901
<b>D</b>	<b><i>Pasuria</i></b>	<b>10 372 969</b>
1	Blerje makine 500,000 lekë në dt.15.09.2011	500 000
2	Pagesë e datës 26.04.2011, vlera 10,000 euro për apartamentin	1 383 000
3	Pagesë e datës 13.05.2011, vlera 9,135 euro për apartamentin	1 263 371
4	Pagesë e datës 17.05.2011 për apartamentin vlera 865 euro	119 630
5	Pagesë e bërë cash për apartamentin 10,000 euro datë 16.04.2011	1 383 000
6	Pagesë e datës 17.08.2011, vlera 19,000 euro për apartamentin	2 627 700
7	Pagesë e datës 1.11.2011, vlera 1,000 euro për apartamentin	138 300
8	Likuiditete në bankë 01.11.2011	2 957 969
	<b>Rezultati financiar (A+B-C-D)</b>	<b>(2 462 188)</b>

Konstatohet se nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë pasur mundësi për të shlyer me të ardhura të ligjshme vlerën e këstit, duke rezultuar me balancë negative në shumën 2,462,188 lekë.

***Kësti VII - shlyer në datën 5.12.2011, pagesë cash, në vlerën 1,000 euro***

**1.9.7** Subjekti, me pyetësorin nr. 3, shpjegon se: “[...] Gjithashtu në muajin dhjetor, këtij shtetasi (L.B.) i është dhënë dhe 1,000 euro cash në përmbyllje të shumës totale të apartamentit”.

**1.9.7.1** Komisioni, me qëllim identifikimin e mundësisë për të kryer pagesën e këtij kësti me të ardhurat e deklaruara, hetoi tërheqjet dhe derdhjet në llogaritë bankare të subjektit dhe bashkëshortes prej datës 1.11.2011, kur është kryer pagesa në vlerën 1,000 euro, deri më 31.12.2011, nga e cila rezultoi si vijon:

**Tabela nr. 3**

<i>Periudha</i>	<i>Tërheqje/lekë</i>	<i>Kreditime nga paga/lekë</i>
<i>A.N.</i>		
Nëntor 2011	78 676	85 611
	136 495	54 092
<i>A.N.</i>		
Nëntor 2011	53 168	64 956
Dhjetor 2011	32 400	69 660
<b>Totali</b>	<b>300 739</b>	<b>274 319</b>
<i>Rezultati financiar</i>		<i>( 26 420)</i>

Pra, nga veprimet e kryera gjatë periudhës nëntor – dhjetor 2011, subjekti rezulton me mungesë burimesh financiare në shumën 26,420 lekë.

Gjithashtu, edhe duke iu referuar analizës financiare përmbledhëse për periudhën 2003 – 2016, përkatësisht balancës në fund të vitit 2011, e cila rezulton me vlerë negative prej 1,726,866 lekësh, konstatohet se subjekti nuk ka pasur mundësi të kryejë pagesën e këstit të VII me të ardhura të ligjshme.

**1.10** Komisioni, gjatë hetimit të kësaj pasurie, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit:

i) nuk ka provuar me dokumentacion ligjor pagesat *cash* për shumat 10,000 euro dhe 1,000 euro deklaruar të paguara shtetasit L.B.;

ii) nuk ka shpjeguar dhe provuar burimin e ligjshëm të shumës 3,000 euro të këstit të paguar *cash* në datën 16.4.2011;

iii) nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 dhe as në deklaratën *Vetting* huat në shumat 1,300,000 lekë (nga znj. V.H.) dhe 10,792 euro (nga znj. N.A.), që kanë shërbyer si burim për pagesat e kësteve të apartamentit, si dhe nuk ka provuar me dokument ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre shumave;

iv) së bashku me bashkëshorten nuk kanë pasur mundësi të kryejnë pagesat e apartamentit, duke rezultuar me mungesë burimesh financiare deri në fund të 2011 në vlerën 1,726,866 lekë.

Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**1.11** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar në lidhje me shumën 10,000 euro se 7,000 euro janë tërhequr në datën 12.1.2011 nga llogaria e bashkëshortes. Për shumën 3,000 euro, subjekti shpjegon në pyetësorin nr. 3<sup>21</sup> se është dhënë transaksioni i tërheqjes bankare të shumës 3,000 euro dhe burimi i saj, edhe pse ishte përfshirë përshkrimi i transaksionit, nga nxitimi ka munguar pjesa e poshtme e përshkrimit të plotë të tij.

**1.11.1** Për mosdeklarimin e huave në DIPP-të periodike dhe në deklaratën *Vetting*, si burim krijimi i pagesave për këstet e apartamentit, subjekti ka shpjeguar se nuk është bërë deklarimi i tyre për shkak se huat kanë qenë të përkohshme, janë kthyer brenda vitit dhe nuk kanë qenë

<sup>21</sup>Pyetësori nr. 3, pyetje 5/III, shihni sqarimin në pikën 1.9.5.4 të vendimit.

burim real financimi për blerjen e apartamentit, për sa kohë që si familje dispononte të gjithë shumën e marrë hua në depozitë dhe për shkak të luhatjes së kursit të këmbimit nuk është përdorur për të mos pasur humbje.

**1.11.2** Lidhur me dokumentacionin për të provuar burimin e ligjshëm të huas së marrë në shumën 1,300,000 lekë nga znj. V.H., subjekti ka shpjeguar se të ardhurat e saj janë: nga punësimi; pensioni familjar; ndihma sociale nga shoqata humanitare; nga bashkëshorti i saj; interesa nga shoqëria huamarrëse “\*\*\*”; si dhe nga shitja pasurive të paluajtshme, për të cilat është depozituar dokumentacioni justifikues<sup>22</sup>.

**1.11.3** Ndërsa për shumën 10,792 euro dhënë hua nga huadhënësja N.A., subjekti ka shpjeguar se si burim për krijimin e kësaj shume kanë shërbyer të ardhurat nga: punësimi i saj; punësimi i bashkëshortit; nga shitja e një shtëpie; të ardhura nga produktet bujqësore; të ardhurat nga bashkëshortja A.N. përpara martese; si dhe nga mësimdhënia, për të cilat është depozituar dokumentacioni justifikues<sup>23</sup>.

**1.11.4** Për mungesën e burimeve financiare në vlerën 1,726,866 lekë deri në fund të vitit 2011, subjekti ka shpjeguar se kjo është pasaktësi e Komisionit, pasi në analizën financiare nuk është përfshirë:

i) vlera e këstit të shlyer *cash* në shumën 11,000 euro nga shtetasi L.B., ku lidhur me pagesën e këstit të parë në shumën 10,000 euro është detajuar hollësisht burimi i krijimit dhe tërheqjen nga banka, si dhe kontratat e sipërmarrjes, si dokument ligjor që konfirmon këtë pagesë;

ii) vlera 1,000 euro, si shpenzim, në një kohë që është argumentuar se kjo pagesë ka qenë më se e justifikuar me burime të ligjshme;

iii) vlera 792 euro, pagesa e pjesës së huas kthyer nënës së bashkëshortes, ku siç është sqaruar, për shkak të marrëdhënies së posaçme nënë-bijë, kjo shumë është dhënë *cash*;

iv) shpenzime të konsideruara nga derdhjet *cash* në llogarinë e bashkëshortes, ku janë përfshirë shumat 170,000 lekë, 2568.53 USD dhe 200 euro, që i korrespondojnë transaksioneve të znj. E.S. (kolege e punës së bashkëshortes), znj. B. L. (tezja e bashkëshortes) dhe z. H.B. (koleg i bashkëshortes dhe punonjësi i sigurisë së bankës).

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**1.12** Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, në lidhje me vlerën plotësuese të këstit të parë prej 3,000 euro, janë të pasqyruara në statementin bankar të përcjellë nga institucionet financiare. Konfirmohet se kjo vlerë është tërhequr nga llogaria bankare në datën 1.2.2011 nga bashkëshortja e subjektit.

**1.12.1** Gjithashtu, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 pakësimin e gjendjes së llogarisë bankare të tij dhe të bashkëshortes në BKT, e cila ishte akumuluar nga kursimet ndër vite. Po ashtu, në referencë të analizës financiare të kryer, rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja kanë pasur mundësi për të kursyer vlerën e këstit të parë.

<sup>22</sup>Vërtetime nr. \*\*\* prot., datë 4.8.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 10.8.2021, nga ISSH-ja; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2021, nga shoqata “Gjysmë hëna e kuqe e E.B.A”; vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2021, lëshuar nga fondacioni “\*\*\*”, përgjigjja me nr. \*\*\* prot., datë 6.8.2021, e ASHK-së, Zyra Vendore Pukë, etj.

<sup>23</sup>Vërtetim datë 3.8.2021, nga ISSH-ja Dibër; kontrata premtim-shitje nr. \*\*\*, datë 18.1.2013; vërtetim për mësimdhënie.

**1.12.2** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit provoi ekzistencën në llogarinë bankare të bashkëshortes të shumave 7,000 euro dhe 3,000 euro, tërheqjen e tyre dhe pagesën e kështit të parë për blerjen e apartamentit brenda një periudhe kohore prej 2 muaj e gjysmë dhe se pagesa e kështit të parë prej 10,000 euro është kryer me kursime nga të ardhura të ligjshme të provuara bindshëm nga subjekti i rivlerësimit.

**1.12.3** Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme lidhur me shlyerjen e vlerës 54,800 lekë të padeklaruar prej tij gjatë procesit të rivlerësimit, që korrespondon me një sistemim për efekt të ndryshimeve të kursit të këmbimit të monedhës USD/lekë.

**1.12.4** Referuar huas së marrë prej prindërve të bashkëshortes, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit të dhëna pas përcjelljes së rezultateve të hetimit, në seancën dëgjimore, si dhe dokumentacioni ligjor i vënë në dispozicion, janë të mjaftueshme për të arritur nivelin e provueshmërisë dhe besueshmërisë. Subjekti shpjegoi se për shkak të marrëdhënies së posaçme nënë-bijë dhënia e huas është bërë pa dokumente, në formë verbale. Gjithashtu, në vijim të shpjegimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti ka përcjellë dokumentacion provues ligjor për të ardhurat e prindërve të bashkëshortes. Subjekti ka arritur të provojë me dokumentacion<sup>24</sup> të ardhurat e babait të bashkëshortes për periudhën 1971 – 2012, ku rezultoi se të ardhurat *neto* të babait për periudhën 1.1.1994 – 31.3.2011, janë në vlerën 4,365,446 lekë. Mbi të ardhurat e nënës së bashkëshortes, për periudhën 16.9.1971 – 6.6.2012, është përcjellë dokumentacion<sup>25</sup>, nga i cili rezultoi se të ardhurat *neto* me burim pagën, deri në prill të vitit 2011 janë në vlerën 3,436,308 lekë. Në analizë të dokumentacionit të përcjellë në Komision, mbi të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit përpara fillimit të bashkëjetesës me të (përpara vitit 2006), rezultoi se të ardhurat *neto* përpara kësaj periudhe janë në vlerën 680,877 lekë. Në përmbledhje të sa konkluduar nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, rezultoi se prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit kanë pasur mundësi të financiarë për të dhënë hua me të ardhura të ligjshme sipas tabelës në vijim.

**Tabela nr. 4**

<i>Periudha 2003 – 24.4.2011</i>	<i>Totali në lekë</i>
<b><i>Të ardhurat</i></b>	<b>6 108 169</b>
Të ardhurat N.A.	2 336 547
Të ardhurat Sh.A.	3 090 745
Të ardhurat para martesë A.A.	680 877
<b><i>Shpenzimet</i></b>	<b>5 941 660</b>
Shpenzime jetese për 3 anëtarë deri në vitin 2007 dhe më pas për 2 anëtarë	2 839 830
Pagesa e kështit të parë për blerje apartamenti, datë 22.4.2011, transferuar nga llogaria në “Raiffeisen Bank”	1 383 000
Hua dhënë A.A. për blerje apartamenti	1 492 534

<sup>24</sup>Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Drejtoria Rajonale Dibër datë 3.8.2021; shtetasi Sh.A., Këshilli Popullor i qytetit për periudhat 15.8.1971 - 30.1.1973 dhe 17.1.1976 – 30.8.1977; Këshilli i bashkuar për periudhën 17.8.1977 – 31.8.1985; KB T. për periudhën 1.9.1985 - 28.2.1989, Drejtoria Arsimore Dibër për periudhën 1.10.1992 - 19.01.2012.

<sup>25</sup>Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore; Drejtoria Rajonale Dibër datë 3.8.2021; Qendra ekonomike e arsimit Peshkopi për periudhën 16.9.1971 – 1.4.1976; shkolla e mesme bujqësore Peshkopi për periudhën 1.4.1976 – 31.12.1997, Bashkia Peshkopi për periudhën 1.1.1998 – 1.1.2012, Zyra e punësimit Dibër për periudhën 1.1.2012 - 6.6.2012; pension më 6.6.2012 e në vijim.

Ndryshimi i gjendjes së likuiditeteve në bankë A.A.	226 297
<b>Rezultati financiar</b>	<b>166 509</b>

**1.12.5** Në vlerësim të Komisionit, për huan e dhënë nga motra e subjektit të rivlerësimit, znj. V.H. në vlerën 10,000 euro, rezultoi se subjekti, me dokumentacionin ligjor<sup>26</sup> të përcjellë pas dërgimit të rezultateve, arriti të provojë mundësinë financiare të motrës, për të dhënë huan me të ardhura të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

**1.12.6** Subjekti provoi se për periudhën 1984 – 31.12.1993, motra e subjektit ka pasur të ardhura *neto* në shumën 98,318 lekë dhe për periudhën 1994 –31.12.2011, të ardhura në shumën 3,691,186 lekë. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit provoi<sup>27</sup> se të ardhurat e nipërve të tij, E. dhe A.H. të cilët janë trajtuar me pension familjar, rezultojnë se për periudhën 24.3.1999 –maj 2011, të kenë përfituar vlerën 1,171,986 lekë dhe përveç saj kanë përfituar edhe ndihmë ekonomike nga shoqëri dhe fondacione<sup>28</sup> bamirësie vlera e të cilave ka qenë 49 USD/muaj dhe 37 USD/muaj për periudhën 1.1.2007 – 30.6.2012. Komisioni vlerësoi se përfitimi i këtyre vlerave monetare ka pasur qëllim mbulimin e shpenzimeve jetike për këtë lloj kategorie përfituesish. Duke u mbështetur në sa më sipër, dhe për shkak se në analizën financiare të personit tjetër të lidhur janë përfshirë shpenzime jetike edhe për fëmijët, u vlerësua përfshirja edhe e këtyre të ardhurave në analizën financiare. Gjithashtu rezultoi se përveç të ardhurave të mësipërme, subjekti ka arritur të provojë edhe të ardhura të fituara nga shitja e banesës në Fushë-Arrëz. ASHK<sup>29</sup>-ja, Zyra Vendore Pukë konfirmon se shtetasit V.H. dhe M.H., me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 12.4.1995, kanë shitur apartamentin në pronësi të tyre për çmimin 350,000 lekë. Po ashtu, u provua me dokumentacion edhe tërheqja nga kunati i subjektit, z. M.H., të shumës 711,753 lekë në datën 1.4.1998 dhe të shumës 120,000 lekë në datën 21.6.1998 nga arka e kursimeve. Në përmbledhje, Komisioni vlerësoi të provuar dhe të shpjeguar në mënyrë shteruese dhënien e huas nga shtetasja V.H. në vlerë 1,300,000 lekë, me të ardhura të ligjshme sipas tabelës në vijim.

**Tabela nr. 5**

<i>Periudha 1998 – 13.5.2011</i>	<i>Totali në lekë</i>
<b><i>Të ardhurat</i></b>	<b>6 138 435</b>
Të ardhurat V.H.	3 280 025
Të ardhurat e pensioneve të fëmijëve nga fondacionet bamirëse	196 866
Të ardhurat nga pensionet familjare për fëmijët	1 479 791
Të ardhurat nga shitja e banesës në Fushë-Arrëz	350 000
Të ardhura të depozituara në Bankën e Kursimeve	831 753
<b><i>Shpenzimet</i></b>	<b>5 919 492</b>

<sup>26</sup> Vërtetimi i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Shkodër, me nr. \*\*\* prot, datë 4.8.2021 vërtetimit të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tiranë, me nr Prot \*\*\*, datë 6.8.2021.

<sup>27</sup> Vërtetimit të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore , Drejtoria Rajonale Tiranë, me nr Prot \*\*\*, datë 10.8.2021

<sup>28</sup> Vërtetimi i lëshuar nga shoqata humanitare “\*\*\*” e E.B.A , nr Prot \*\*\*, datë 20.5.2021, Vertetimit nr \*\*\* prot dt 3.8.2021, lëshuar nga fondacioni “\*\*\*”.

<sup>29</sup> Shkresa ASHK me nr prot \*\*\* datë 6.8.2021.

Shpenzime jetese për 4 anëtar deri në 1998 dhe në vijim për 3 anëtar	4 619 492
Huaja dhënë A.A.	1 300 000
<b>Rezultati financiar</b>	<b>218 943</b>

**1.12.7** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse për sa i përket shlyerjes së këstit në vlerën 1,000 euro për blerjen e apartamentit, si dhe ka shpjeguar se shtetasi H.B. ka qenë punonjës i bankës ku bashkëshortja e tij punonte dhe njëkohësisht i njohur i prindërve të saj. Në lidhje me analizën financiare të mundësisë për të kursyer vlerën 1,000 euro nga bashkëshortja dhe subjekti të kryer nga Komisioni, rezultoi se kanë pasur mundësi të kursejnë këtë vlerë me të ardhura të ligjshme në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

**1.12.8** Komisioni vlerësoi se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe bindëse, në lidhje me veprimet bankare të kryera në llogarinë e bashkëshortes nga persona të tretë, të tilla si transaksionet e kryera nga znj. E.S. (kolege e punës së bashkëshortes) në vlerën 170,000 lekë dhe nga znj. B.L. (tezja e bashkëshortes) në shumën 2,568.53 USD. Subjekti provoi<sup>30</sup> se znj. E.S. ka qenë punonjëse e bankës ku punon bashkëshortja dhe se vlera e mësipërme është kthimi i huas së dhënë nga bashkëshortja e subjektit me veprime bankare të konfirmuara nga statement i BKT-së. Marrëdhënia mes znj. E.S., ish-punonjëse e BKT-së, është marrëdhënie mes kolegesh, në një periudhë kur kjo e fundit kishte shpenzime mjekësore përtej normales. Ndërsa në lidhje me vlerën prej 2,568.53 USD të derdhur në llogarinë e bashkëshortes nga shtetasja B.L., e cila është tezja e bashkëshortes së subjektit, shpjegon se shuma në fjalë i është kaluar bashkëshortes për t'u këmbyer prej saj me një kurs preferencial, të cilin e ofron banka për punonjësit e saj. Kjo vlerë është tërhequr nga bashkëshortja në datën 8.9.2011 dhe i është kthyer znj. B.L., një pjesë *cash* në shumën 160,000 lekë dhe në datën 10.10.2011 shuma 105.000 lekë. Këto veprim janë konfirmuar nga statement i BKT-së.

Nga sa më sipër, Komisioni, duke u mbështetur edhe në provueshmërinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, vlerësoi bindëse dhe të faktuara shpjegimet e tij. Subjekti paraqiti një sërë veprimesh bankare dhe transaksione të kryera prej tij, të cilat ndërlidheshin mes tyre e gjithashtu kishin edhe burim të ligjshëm e të provuar. Nisur nga rrethanat e faktuara, dokumentacioni i administruar gjatë hetimit si dhe shpjegimet e subjektit, trupi gjykues krijoi bindjen se mosdeklarimi në DIPP-në e vitit 2011 të huave të marra nga personat e tjerë të lidhur të cilat janë zëvendësuar po brenda vitit me të ardhura të vetë subjektit të rivlerësimit, të cilat rezultuan të provuara dhe të ligjshme, nuk ka qenë një domosdoshmëri për deklaram në deklaratat përkatëse të pasurisë. Dyshimet e ngritura nga komisioni mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave të vetë subjektit shuhën, pasi vlerësohen transaksionet dhe veprimet e kryera nga subjekti dhe personat e tjerë të lidhur me të, lidhur me marrjen e shumave dhe kthimin e tyre brenda të njëjtës periudhë deklaruese, brenda vitit 2011, dhe pas arritjes së provueshmërisë së burimit të krijimit të tyre me të ardhura të ligjshme nga huadhënësit dhe kthimit të tyre po me të ardhura të ligjshme nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të. Duke qenë se këto situata faktike janë të justifikuara/kuptueshme dhe veprimet ndërlidhen mes tyre e gjithashtu

<sup>30</sup>Vërtetim nr. \*\*\*, datë 18.8.2021, BKT-ja.

konsiderohen bindëse, vetëm mosdeklarimi i saj i vlerësuar si një pakujdesi e subjektit (apo harresë prej tij) nuk mund të përbëjnë shkak për dhënien e masës disiplinore.

Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur prova të mjaftueshme për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit e se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshortja kanë pasur burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në vlerën 7,140,000 lekë ose 51,000 euro.

### **Analizë e përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese**

**1.13** Nga BKT-ja<sup>31</sup> konfirmohet dhënia e kredisë në shumën 2,580,000 lekë me kredimarrës shtetasit L. dhe Arben Nika, ndërsa shtetasja A.N. si dorëzanëse. Është depozituar dhe shkresa e datës 1.6.2010 e Bashkisë Peshkopi, ku pasqyrohet lista e familjeve të pastreha, të cilat janë miratuar për trajtim me kredi të lehtësuar bazuar në udhëzimin nr. 6257, datë 2.9.2008, i ndryshuar, ku bashkëlidhur është kopje e vendimit nr. 16, datë 24.5.2010, i Këshillit Bashkiak Peshkopi, për miratimin e kësaj liste, ku shtetasi L.N. rezulton në listë me nr. rendor \*\*\*.

**1.13.1** Subjekti ka depozituar me deklaratën *Vetting* dokumentacionin e përfitimit të kësaj kredie, me garantues hipotekor F. dhe B.L. dhe i pyetur nga Komisioni, gjatë hetimit<sup>32</sup> lidhur me këta dy shtetas, ka shpjeguar se shtetasi F.L. është bashkëshorti i tezes së bashkëshortes.

**1.13.1.1** Komisioni ka hetuar për ndonjë situatë konflikti interesi me shtetasit F. dhe B.L. dhe nga korrespondenca e kryer<sup>33</sup> nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

**1.13.2** Subjekti është pyetur të shpjegojë dhe të provojë me dokument ligjor në lidhje me vendbanimin e tij dhe babait para vitit 2000 dhe deri në vitin 2016. Subjekti ka shpjeguar vendbanimet/vendqëndrimet ku ka jetuar ai dhe babai i tij për periudhën e kërkuar, por është në pamundësi të vënies në dispozicion të dokumentacionit përkatës të kërkuar nga Komisioni<sup>34</sup>.

**1.13.3** Komisioni ka administruar përgjigjen e ASHK-së Zyra Vendore Pukë dhe Dibër<sup>35</sup>, ku konfirmohet se shtetasit Arben, L. dhe A.N. nuk kanë pasuri të paluajtshme të regjistruara.

---

<sup>31</sup>(i) kontratë kredie datë 26.7.2011 me kredithënësit BKT sh.a. dhe kredimarrësit L.N. dhe Arben Nika dhe dorëzanës znj. A.N. (A.), z. F.L. dhe znj. B.L. për kredi në shumën 2,580,000 lekë me kushtin paraprak të përdorimit të kredisë vetëm për qëllimi blerje apartamenti sipas Aneksit të çeljes dhe përdorimit të kredisë. Palët kanë rënë dakord që të lidhin këtë kontratë kredie në bazë të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane” i ndryshuar, VKM-ja nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civil të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë; Udhëzimin nr. 6257, datë 2.9.2008 “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti dhe udhëzimit të përbashkët etj., dhe marrëveshjes tri palëshe datë 18.2.2009; (ii) kontratë hipoteke të datës 26.7.2011 me garantuesit hipotekorë F. dhe B.L., të cilët vënë në kolateral në favor të bankës apartamentin në pronësi të tyre me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sip. 135 m<sup>2</sup>, me adresë lagjja “\*\*\*”, p \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, Peshkopi; (iii) formë aplikimi-kredi për shtëpi e datës 4.7.2011, ku përcaktohet shuma e huas së kërkuar (2,580,000 lekë) qëllimi i huas – blerje shtëpie, kredimarrësit Arben dhe A.N., specifikuar me qira prej 3 vitesh; (iv) klauzola e pëlqimit paraprak nënshkruar nga shtetasit Arben Nika dhe A.A.; vërtetimi i datës 4.7.2011, lëshuar nga Bashkia Peshkopi, ku vërtetohet se shtetasi L.N. është banor në lagjen “\*\*\*”; (v) vendimi nr.16, datë 24.5.2010, i Këshillit Bashkiak Peshkopi, i cili vendosi të miratojë listën e klasifikuar të të pastrehëve për trajtim me kredi favorizuese nëpërmjet bankës sipas listës bashkëlidhur me 88 familje, listë që i kalon për trajtim BKT-së.

<sup>32</sup>Përgjigjja 7 e pyetësorit nr. 2.

<sup>33</sup>Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Dibër dhe Kurbin, përkatësisht me korrespondencat nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2021, nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2021.

<sup>34</sup>Shihni pyetësorin nr. 2.

<sup>35</sup>ASHK-Zyra Vendore Pukë me nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2021; ASHK – Drejtoria Vendore Dibër me nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2021.



**1.13.4** Bashkia Peshkopi<sup>36</sup> ka përcjellë dokumentacionin për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese nga babai i subjektit L.N.<sup>37</sup>.

**1.13.5** Komisioni ka administruar përgjigjen e DPGJC-së<sup>38</sup>, ku konfirmohet se familja Nika (L. dhe Arben Nika) në datën 12.5.2010 ka ndryshuar vendbanimin, duke u zhvendosur nga Njësia Administrative Nr. \*\*\*, Tiranë, në Bashkinë Peshkopi deri më 31.8.2012.

**1.13.6** Subjekti është pyetur nga Komisioni në lidhje me adresën, rruga “\*\*\*”, që është deklaruar prej tij në mënyrë të vazhdueshme në deklaratat periodike dhe ka shpjeguar se në këtë adresë kanë jetuar motrat me familjet e tyre dhe se ai nuk ka jetuar me qira dhe nuk ka pronë të blerë prej tij dhe babait në këtë adresë. Kjo adresë është deklaruar si adresë e dytë vetëm për kontakt.

**1.13.7** Komisioni ka konstatuar se në VKM-në nr. 904, datë 17.12.2014, “Për trajtim me kredi të lehtësuara për strehim të familjeve që banojnë në objekte të ish-ndërmarrjes shtetërore në rr. “\*\*\*”, Tiranë”, në listën me emra bashkëngjitur rezulton me nr. rendor \*\*\*, shtetasi L.N. Pra, në dukje krijohet ideja se shtetasi L.N. ka banesë në godinën e ish- ndërmarrjes shtetërore në rrugën “\*\*\*”.

**1.13.7.1** Subjekti, i pyetur nga Komisioni<sup>39</sup> lidhur këtë konstatim, mohoi të ketë banesë në këtë adresë dhe pohon se e ka deklaruar si adresë dytësore për kontakt, por që nuk ka lidhje me familjen e tij. Subjekti ka shpjeguar se përfshirja e babait të tij në VKM është bërë si person madhor që ka jetuar aty dhe jo si person që ka pasur banesë dhe, gjithashtu, deklaroi se nuk ka pasur dijeni që dy motrat e tij të kenë aplikuar për kredi dhe se nga ana e babait nuk është tentuar dhe as është kërkuar ndonjëherë, pasi nuk ishte banor që zotëronte një banesë.

**1.13.8** Lidhur me kredinë me kushte lehtësuese, Komisioni ka konstatuar se:

a) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/babai kanë ndryshuar gjendjen civile me qëllim përfitimi të kredisë me kushte lehtësuese;

b) duket se kanë pasur një banesë tjetër ku jetonin në Njësinë Administrative Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*”, Tiranë, në kohën kur ata kanë aplikuar për të përfituar kredi me kushte lehtësuese në bashkinë Peshkopi;

c) qëllimi i përdorimit të shumës së marrë si kredi lehtësuese nga subjekti dhe babai është në kundërshtim me ligjin<sup>40</sup>, pasi kjo kredi nuk është përdorur për të blerë banesë brenda territorit

<sup>36</sup>Bashkia Peshkopi me nr. \*\*\* prot., datë 8.7.2021.

<sup>37</sup>Dokumentacioni i përcjellë nga Bashkia Peshkopi: (i) kërkesë e z. L.N. datë 12.5.2010, drejtuar Bashkisë Peshkopi (zyrës së strehimit), ku deklaroi se meqenëse me djalin dhe gjithë familjen banojnë në Peshkopi me qira për shkak të punës së djalit mendojnë se plotësojnë kriteret ligjore për t’u trajtuar si të pastrehë me një nga programet sociale të bashkisë; (ii) vërtetim datë 12.5.2010, lëshuar nga ZVRPP-ja Dibër për shtetasin L.N. që nuk ka të regjistruar pasuri të (ndërtesë/apartament) në këtë ZVRPP; (iii) certifikatë familjare datë 12.5.2010, lëshuar nga ZGJC-ja Bashkia Peshkopi me përbërje (L., Arben, A. E. dhe B.N.); (iv) vërtetim page datë 18.4.2011, lëshuar nga Prokuroria Kurbin për z. Arben Nika; (v) nxjerrje llogarie page nga BKT-ja në qershor të vitit 2011 për znj. A.N.; (vi) vërtetim datë 4.7.2011, lëshuar nga Bashkia Peshkopi që vërtetoi se z. L. N. është banor i këtij qyteti në lagjen D.; (vii) kërkesë- fazë e parë aplikimi për t’u trajtuar me strehim bazuar në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, plotësuar nga z. L.N.; (viii) vendim nr.16, datë 24.5.2010, i Këshillit Bashkiak “Për miratimin e listës së klasifikuar të të pastrehëve për trajtimin me kredi lehtësuese nëpërmjet bankës”. Lista bashkëngjitur ku z. L.N. rezulton me numër rendor nr. \*\*\*, me përbërje familjare 5 persona, struktura e apartamentit që përfiton 3+1, vlera maksimale e apartamentit të përfiton 3,332,800 lekë, të ardhurat mujore të familjeve të deklaruara = 120,000 lekë.

<sup>38</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2021, e DPGJC-së.

<sup>39</sup>Shihni pyetësorin nr. 2.

<sup>40</sup>Ligji nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar (tashmë i shfuqizuar me ligjin nr. 22/2018), i cili parashikon kushtet dhe kriteret ligjore të përfitimit nga programet sociale të strehimit

të bashkisë Peshkopi, e cila në ushtrim të juridiksionit territorial ka akorduar këtë kredi, por banesa është blerë në qytetin e Tiranës;

ç) aplikues për kredi ka qenë babai i subjektit L.N., ndërsa përfitues i kredisë përveç tij ka qenë dhe subjekti Arben Nika, ndërsa aplikues për kredi në bankë ishte subjekti dhe bashkëshortja.

Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**1.14** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe në seancë dëgjimore, ka shpjeguar se mbi ndryshimin e gjendjes civile, bashkë me babanë, janë vënë në dijeni se Bashkia Peshkopi mund të akordonte kredi lehtësuese për banorët e zonave urbane që nuk kishin banesë për t'u strehuar dhe si kusht për aplikimin e përfitimit të kësaj kategori kredie ishte të qenurit banor i saj. Në këto rrethana, duke e konsideruar veten dhe familjen e tij pa banesë dhe banor *de facto* i bashkisë Peshkopi, ku subjekti punonte prej 10 vjetësh, për t'u bërë pjesë e aplikimit është transferuar gjendja civile.

**1.14.1** Lidhur me adresën në rrugën “\*\*\*”, subjekti ka shpjeguar se ai dhe familja e tij nuk ka pasur në pronësi/përdorim asnjë banesë në këtë adresë. Në ambientin ish-magazinë të ish-ndërmarrjes shtetërore, i përshtatur për banim nga 3 motrat, ka jetuar edhe babai i tij, fakt ky që nuk e bën subjektin apo babanë pronar të tij.

**1.14.2** Referuar faktit që kredia nuk është përdorur për të blerë banesë në Peshkopi, por në Tiranë, subjekti ka shpjeguar, se kjo lloj kredie lehtësuese nuk ka asnjë dispozitë ndaluese në ligj me blerjen e një banese jashtë zonës ku është akorduar kredia, dhe se kredia e akorduar dhe e disbursuar ka pasur si qëllim, pikërisht, blerjen e apartamentit në Tiranë.

**1.14.3** Lidhur me faktin se aplikues për kredi lehtësuese ka qenë babai i subjektit, subjekti ka shpjeguar se përfshirja e tij dhe e bashkëshortes në kredimarrje ka qenë për garantimin e përmbushjen e shlyerjes së saj.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**1.15** Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme lidhur me kredinë me kushte lehtësuese me përfitues babanë e tij, nga projekti i strehimit nga Bashkia Peshkopi.

Trupi gjykues vlerëson se palët, kreditor dhe debitor, janë subjektet e marrëdhënies juridike që lind gjatë procesit të kreditimit dhe se pala aplikuese dhe përfituese e statusit të të pastrehut, e për rrjedhojë edhe e kredisë ka qenë babai i subjektit dhe jo vetë subjekti, për më tepër nën statusin e zyrtarit prokuror.

Trupi gjykues, pas vlerësimit tërësor dhe individual të akteve shkresore dhe shpjegimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, lidhur me marrëdhënien e kreditimit, në BKT, vlerësoi se kjo kredi është marrë nga babi i subjektit të rivlerësimit si përfitues i saj me statusin i pastrehë, duke vlerësuar se mungon përgjegjësia konkrete e subjektit të rivlerësimit, lidhur me mënyrën e përfitimit të kredisë nga babai i tij.

---

në kushtet dhe kriteret e përfitimit për programet e strehimit kanë qenë të parashikuara në kreun V, neni 17 e vijues si dhe neni 25 i këtij ligji. Konkretisht, në nenin 18 të këtij ligji, përcaktoheshin kriteret mbi bazën e të cilave përfitonin të pastrehët:... a) familjet që në çastin e paraqitjes se kërkesës pranë zyrës përkatëse të bashkisë nuk kanë në pronësi një banesë; ...

Më pas, babai i subjektit ka nënshkruar kontratën e kredisë me BKT, për apartamentin në Tiranë, ku palë ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit për shkak të faktit se ai kishte të ardhura të dokumentuara (pagë të deklaruar) e do të mund të shërbente si një garanci për vetë bankën. Sipas parashikimeve të neneve 585 e vijues të Kodit Civil, në këtë rast, subjekti dhe bashkëshortja e tij, detyroheshin t'i siguronin kreditorit, në këtë rast, Bankës Kombëtare Tregtare, ekzekutimin e detyrimit të debitorit kryesor, nëse ai nuk do ta përmbushte atë.

Për sa më sipër arsyetuar, trupi gjykues vlerëson se nuk ka shkaqe ligjore për të ngarkuar me përgjegjësi ligjore subjektin e rivlerësimit, lidhur me rrethanat mbi përfitimin e kësaj kredie me kushte lehtësuese, aplikimin, deklarimin mbi plotësimin e kushteve dhe ligjshmërinë e përfitimit të saj nga babai i tij.

## **2. Garazhe në apartamentin e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, zona e F., Tiranë**

Pasuria e sipërcituar, me kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 3.7.2013, është e paregjistruar në ZVRPP-në Tiranë, për arsye të mbivendosjes së pronës. Vlera: 1,000,000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: kursimet nga të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes.

**2.1** Në DIPP e vitit 2013, subjekti ka deklaruar blerjen e kësaj pasurie në vlerën 1,000,000 lekë, si dhe detyrimin e mbetur ndaj shtetasit L.B. në vlerën 500,000 lekë. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, në DIPP-të për vitet 2017 dhe 2018, ka deklaruar detyrimin e mbetur për t'u paguar për garazhet e blera.

**2.2** Subjekti ka depozituar kontratën e porosisë, datë 3.7.2013<sup>41</sup>, me palë sipërmarrëse shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori P.M. dhe palë porositëse Arben Nika me dhënës pëlqimi L.B. për 2 vendparkime. Vlera totale për 2 garazhet është 1,000,000 lekë, shumë e cila do të likuidohet deri në datën 31.12.2013, kundrejt një deklarate noteriale të firmosur nga pala dhënëse e pëlqimit dhe porositësi.

**2.3** ASHK-ja Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1<sup>42</sup> nuk konfirmon pasuri të llojit “garazh” të regjistruar në emër të subjektit Arben Nika.

**2.4** Subjekti, i pyetur nga Komisioni se përse nga viti 2013 dhe deri më sot nuk i ka të regjistruar në ASHK garazhet, ka shpjeguar se kjo ka ndodhur për shkak të mosmarrëveshjeve të pronarëve të tokës me ndërtuesin, lidhur me vendndodhjen e një pjese të parkimeve, mosmarrëveshje që edhe sot janë në proces gjykimi.

**2.4.1** I pyetur nga Komisioni, që të provojë me dokumentacion ligjor pagesën prej 500,000 lekësh duke përcaktuar datën e kryerjes së saj, subjekti ka shpjeguar se kjo pagesë është kryer me të ardhurat e tij dhe bashkëshortes, pagesë e bërë *cash* nga shtetasi L.B., sipas mandatar-këtimit nr. \*\*\*, datë 16.9.2013, të cilin e depozitoi në Komision.

**2.4.2** Subjekti është pyetur në ILDKPKI në vitin 2016<sup>43</sup> për mosrespektimin e kontratës lidhur me pagesën e garazheve, ku ka shpjeguar se nuk ka pasur mundësi financiare për momentin, por në marrëveshje me shitësin do t'i likuidohet në një moment tjetër.

## **Lidhur me burimin e ligjshëm të pagesës së garazheve**

<sup>41</sup>Kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 3.7.2013.

<sup>42</sup>ASHK Zyra Vendore Tiranë Jug me nr. \*\*\* prot., datë 29.4.2020.

<sup>43</sup>Përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2020, e ILDKPKI-së, procesverbali i datës 29.1.2016.

**2.5** Duke u mbështetur në deklaratimet e subjektit, Komisioni hartoi analizën financiare mbi mundësinë e kryerjes së pagesës, duke konsideruar si datë pagese deri në shtator të vitit 2013 dhe vlerën 500,000 lekë, të pasqyruar në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 6**

	<b>Përshkrim</b>	<b>Vlera në lekë</b>
<b>A</b>	<b><i>Të ardhura</i></b>	<b><i>2,177,204</i></b>
1	Likuiditete në bankë 01.01.2013	686,270
2	Të ardhura nga paga e subjektit 01.09.2013	739,017
3	Të ardhura nga paga e b/sh subjektit 01.09.2013	751,917
4	Të ardhura nga interesi	16,379
<b>B</b>	<b><i>Shpenzime</i></b>	<b><i>597,812</i></b>
1	Shpenzime jetike 01.01.2013-01.09.13	376,064
2	Shpenzime qiraje	90,000
3	Shpenzime per kredine ne BKT sha	131,748
4	Shpenzime udhëtimi në funksion të detyrës (2010-2016)	202,386
5	Shpenzime mobilimi	112,667
<b>C</b>	<b><i>Pasuria</i></b>	<b><i>865,452</i></b>
1	Pagesë për blerjen e garazheve, vlera 500,000 leke	500,000
2	Likuiditete në bankë 16.09.2013	365,452
	<b>Rezultati financiar (A-B-C)</b>	<b>713,941</b>

**2.5.1** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur burime të mjaftueshme të ligjshme për krijuar pasurinë në vitin 2013.

**2.6** Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar mospërputhje deklarimi nga ana e subjektit, lidhur me mosrespektimin e kontratës lidhur me pagesat e garazheve, ku në ILDKPKI ka deklaruar pamundësi financiare, ndërsa në pyetësor ka deklaruar problemin e pronësisë të ndërtuesit me pronarët e tokës.

Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**2.7** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se është deklaruar që në fillim dhe më pas në pyetësorë është evidentuar që ka qenë dhe vijon të jetë problemi i punimeve dhe më pas i pronësisë që vijnë ende dhe, për këtë arsye, nuk është vijuar me pagesën përkatëse, pavarësisht të pasurit mundësi pagese. Pagesa e mbetur e pashlyer për këtë pronë do të bëhet në momentin që pronësia ligjore e saj do t'i kalojë subjektit. Deklarimi në ILDKPKI i referohet faktit se nuk ka pasur mundësi financiare për shlyerjen e plotë dhe kjo duhet të ketë qenë edhe arsyeja e mospagesës në momentin e parë të lidhjes së marrëveshjes, përveç shkaqeve ligjore të shpjeguara në pyetësor, por që nuk janë shpjeguar në ILDKPKI.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**2.8** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me problematikat konkrete, kryesisht ato ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e pronësisë, që kanë kushtëzuar pagesën e plotë të çmimit të blerjes së garazheve dhe regjistrimit të tyre në ASHK.

Lidhur me mundësinë financiare për vitin 2013 ka rezultuar se subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshortja kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme financiare për të kryer pagesën përkatëse për këtë pasuri, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera gjatë vitit 2013.

Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë të pasurisë “garazhe” në përputhje me pikën 5/a, të nenit 33, të ligjit 84/2016, si dhe bashkë me personin e lidhur/bashkëshorten kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme financiare për të kryer pagesën përkatëse për këtë pasuri në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

### **3. Automjet tip “Fiat Bravo”, me targa \*\*\***

Kjo pasuri rezulton në emër të bashkëshortes me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 15.9.2011. Vlera: 500,000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: nga kursimet e vitit të subjektit dhe të bashkëshortes.

**3.1** Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri në DIPP-në e vitit 2011 dhe ka depozituar: (i) kontratë shitblerjeje, datë 15.9.2011<sup>44</sup>, me shitës F.M. (përfaqësuar nga z. F.L.) dhe blerës znj. A.N. për blerjen e automjetit tip “Fiat Bravo”, në shumën 500,000 lekë; (ii) deklaratë doganore, datë 15.9.2011, me të cilën shitësi F.M. ka importuar nga Italia automjetin me çmimin 150,000 lekë dhe ka paguar detyrimet tatimore për vlerën 32,105 lekë.

**3.2** Komisioni ka administruar përgjigjen e DPSHTRr-së<sup>45</sup> që konfirmon regjistrimin e automjetit tip “Fiat Bravo”, prodhim i vitit 2002, me targa \*\*\*, në emër të shtetas A.N. dhe dokumentacionin e përfitimit të tij.

**3.3** Komisioni ka hetuar për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit me shtetasin F.L.<sup>46</sup> dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

**3.4.** Komisioni ka kryer analizën financiare mbi mundësinë e subjektit për blerjen e automjetit në datën 15.9.2011, nga ku rezulton se subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë pasur burime të mjaftueshme, për arsye se rezultojnë me pamjaftueshmëri burimesh financiare në vlerën 2,622,330 lekë, sipas tabelës në vijim.

### **Tabela nr. 7**

---

<sup>44</sup>Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 15.9.2011.

<sup>45</sup>DPSHTRR-ja me nr. \*\*\* prot., datë 26.3.2020.

<sup>46</sup>Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Dibër dhe Kurbin, perkatësisht me nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2021 me nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2021.

	<b>Përshkrim</b>	<b>Vlera në lekë</b>
<b>A</b>	<b><i>Të ardhura</i></b>	<b>6 271 593</b>
1	Likuiditete në bankë 01.01.2011	4 845 378
2	Të ardhura nga paga e subjektit 30.08.2011	711 833
3	Të ardhura nga paga e b/sh subjektit 30.08.2011	714 381
<b>B</b>	<b><i>Detyrime</i></b>	<b>2 569 600</b>
	Kredi prane BKT sha date 26.07.2011.	2 569 600
<b>C</b>	<b><i>Shpenzime</i></b>	<b>1 079 990</b>
1	Shpenzime jetike	364 320
2	Shpenzime qiraje	64 000
3	Shpenzime interes i	22 065
4	Shpenzime udhëtimi në funksion të detyrës (2010-2016)	189 704
5	Shuma të derdhura në llog. bankare të bashkëshortes nga persona të tretë, të konsideruara si shpenzime	439 901
<b>D</b>	<b><i>Pasuria</i></b>	<b>10 383 533</b>
1	Blerje makine 500,000 lekë në dt.15.09.2011	500 000
2	Pagesë e datës 26.04.2011, vlera 10,000 euro për apartamentin	1 383 000
3	Pagesë e datës 13.05.2011, vlera 9,135 euro për apartamentin	1 263 371
4	Pagesë e datës 17.05.2011 për apartamentin vlera 865 euro	119 630
5	Pagesë e bërë cash për apartamentin 10,000 euro datë 16.04.2011	1 383 000
6	Pagesë e datës 17.08.2011, vlera 19,000 euro për apartamentin	2 627 700
7	Likuiditete në bankë 15.09.2011	3 106 833
	<b>Mundësia financiare për blerjen e mjetit me burime të ligjshme(A+B-C-D)</b>	<b>(2 622 330)</b>

Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**3.5** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se arsyeja që analiza financiare ka rezultuar me diferencë negative është për arsye se nga Komisioni nuk janë marrë në konsideratë huat. Nga analiza e prezantuar nga subjekti<sup>47</sup> theksohet se automjeti rezulton të jetë nga burime të mjaftueshme financiare. Gjithashtu, në analizën e Komisionit janë përfshirë si shpenzim shumat e derdhura në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit nga persona të tretë.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**3.6** Komisioni, në lidhje me mundësitë financiare, pasi i vlerësoi bindëse dhe shteruese provat e paraqitura nga subjekti për dhënien e huave nga personat e tjerë të lidhur, konkretisht, nga nëna e bashkëshortes dhe motra e subjektit, konstatoi se kursimet e vitit 2011 deri në momentin e blerjes së automjetit, si dhe pakësimi i gjendjes së likuiditeteve në bankë janë të mjaftueshme për kryerjen e këtij investimi.

Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, në cilësinë e personit të lidhur, kanë bërë deklaram të saktë të pasurisë automjet tip “Fiat Brav”, në përputhje me pikën 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të blerë këtë pasuri në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

### **4. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\***

<sup>47</sup>Shihni analizën që subjekti ka përfshirë në prapësimet e tij pas dërgimit nga Komisioni të rezultateve të hetimit.

Ky automjet është blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 2.9.2016. Vlera: 500,000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: blerë me kredi konsumatore të marrë në BKT, në vlerën 924,000 lekë, nga bashkëshortja A.N. (si staf), sipas kontratës së kredisë së datës 17.5.2016.

**4.1** Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në DIPP-në e vitit 2016<sup>48</sup>, si dhe vlerën e blerjes dhe burimin e krijimit të saj.

**4.2** Subjekti ka depozituar: (i) kontratë shitblerjeje, datë 2.9.2016<sup>49</sup>, me shitës R.T. dhe blerës Arben Nika, për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 1999, me targë \*\*\*, në shumën 500,000 lekë, e cila do të likuidohet nëpërmjet “Credins Bank”, ku pala blerëse do të derdhet në llogari të palës shitëse shumën për likuidimin e automjetit; si dhe (ii) kontratë kredie bankare konsumatore, datë 17.5.2016, me kredithënës BKT-në dhe kredimarrës A.A. (N.) me dorëzanës N.M. (Sh.), për kredi në shumën 924,000 lekë, me afat 36 muaj, për blerje automjeti të përdorur dhe rregullim banese.

**4.3** Është administruar përgjigja e DPSHTRr-së<sup>50</sup> që konfirmon regjistrimin e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë \*\*\*, në emër të shtetasit Arben Nika, sipas kontratës së shitjes së datës 2.9.2016<sup>51</sup> me shitës R.T. dhe blerës Arben Nika, në shumën 500,000 lekë, e cila do derdhet në llogarinë e palës shitëse në “Credins Ban”.

**4.4** Komisioni ka hetuar për ndonjë situatë konflikti interesi me shtetasen N.M.<sup>52</sup> dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

**4.5** BKT-ja konfirmon disbursimin e kredisë në shumën 924,000 lekë, në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit A.N. në datën 17.5.2016, nga e cila shuma 424,000 lekë është kaluar menjëherë në depozitë bankare për periudhën 18.5.2016 – 7.9.2016 dhe pjesa tjetër e kredisë është tërhequr *cash*. Me maturimin e depozitës në datën 7.9.2016 gjendja në këtë llogari ka qenë e mjaftueshme për të likuiduar shitësin e automjetit R.T., për shumën 500,000 lekë, por nuk vërtetohet që kjo shumë të jetë transferuar në llogarinë e tij në “Credins Bank”, sipas përcaktimit në kontratën e shitjes.

**4.6** Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se pagesa është kryer nëpërmjet bankës në llogari të shitësit sipas veprimit nr. \*\*\*, datë 7.9.2016, në llogarinë me IBAN CODE \*\*\*, me emërtimin “R.T.”.

Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë me dokumentacion bankar pagesën e çmimit të blerjes së automjetit me një pjesë të kredisë konsumatore, me transfertë bankare në emër të shitësit R.T., duke kryer deklarim të saktë të pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz”, në përputhje me pikën 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të

---

<sup>48</sup>Automjet tip “Mercedes-Benz” me targa \*\*\*, vit prodhimi 2001, blerë në shumën 500,000 lekë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 2.9.2016. Blerë me kredi konsumatore, si staf, të marrë në BKT Tiranë, nga bashkëshortja e subjektit A.N. sipas kontratës së kredisë datë 17.5.2016. Vlera: 500,000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

<sup>49</sup>Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 2.9.2016.

<sup>50</sup>DPSHTRR-ja me nr. \*\*\* prot., datë 26.3.2020.

<sup>51</sup>Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 2.9.2016.

<sup>52</sup>Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Dibër dhe Kurbin, përkatësisht me nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2021 me nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2021.

justifikojë burimin e ligjshëm për të blerë këtë pasuri në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

## **5. Depozitë bankare në emër të bashkëshortes së subjektit A.N., në BKT**

Vlera: 310,018.12 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: kursime nga paga.

**5.1** BKT-ja konfirmon depozitën me nr. \*\*\*, të hapur në datën 4.11.2016, në shumën 130,000 lekë dhe të maturuar më 16.3.2017, në shumën 130,039.90 lekë, si dhe depozitën me nr. \*\*\* të hapur në datën 4.1.2017, në shumën 180,000 lekë dhe të maturuar më 28.4.2017, në shumën 180,38.57 lekë.

Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me deklarinimin e kësaj llogarie.

## **6. Depozitë bankare<sup>53</sup>, në shumën 249,893.35 lekë/secila, në emër të fëmijëve E. dhe B. N., në BKT**

Burimi i krijimi: të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes, ndër vite, si dhe dhuratat e të afërmve nga lindja e fëmijëve.

**6.1** BKT-ja<sup>54</sup> konfirmon llogari bankare në emër të djalit të subjektit E.N. me gjendje në datën 26.1.2017, në shumën 249,489.35 lekë. Fillimisht është krijuar llogari dyemërore<sup>55</sup> për E. dhe A.A. e hapur në datën 25.6.2008, në vlerën 100,000 lekë, transferuar nga llogaria e bashkëshortes. Në këtë llogari janë bërë transfertat të herë pas herë nga llogaria e bashkëshortes dhe janë mbyllur në depozita me afate të ndryshme. Në datën 9.10.2012, kjo llogari mbyllet dhe gjendja në vlerën prej 153,041 lekësh transferohet në llogarinë e re, e cila është edhe llogaria e kursimeve ekzistuese të fëmijëve, ku vlera e saj është shtuar, ndër vite, me kursime dhe me interesat e akumuluar.

**6.2** Ndërsa për depozitën e djalit B.N., BKT-ja konfirmon se gjendja në datën 26.1.2017 është në shumën 249,489.35 lekë. Kjo depozitë është krijuar nga transferimi i vlerës 153,041 lekë nga llogaria e bashkëshortes në datën 9.10.2012 dhe vlera e saj është shtuar, ndër vite, me kursime dhe me interesat e akumuluar.

Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me deklarinimin e kësaj depozite.

## **7. Gjendje cash, kursyer, ndër vite, nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes**

Vlera: 600,000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

**7.1** Subjekti, në deklarinimet periodike vjetore ndër vite, deklaroi si në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 8**

Viti	Deklarimi në DIPP
2003 –2011	Nuk ka deklarim
2012	Kursime nga paga e subjektit dhe e bashkeshortes në vlerën 300,000 lekë
2013	Nuk ka deklarim
2014	Kursime nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes, depozitë në BKT-së dhe cash në vlerën 400,000 lekë

<sup>53</sup>Llogaria nr. \*\*\* për z. E.N. dhe llogaria nr. \*\*\* për z. B.N.

<sup>54</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2020, nga BKT-ja.

<sup>55</sup>Llogaria nr. \*\*\*.



2015	Nuk ka deklarin
2016	Kursime nga paga e subjektit si prokuror dhe e bashkëshortes, cash në vlerën 500,000 lekë. Nga kjo shumë 200,000 lekë janë pjesë e papërdorur e kredisë konsumatore marrë nga bashkëshortja (si staf i BKT-së) me kontratën e datës 17.5.2016, pjesë takuese 50%.

**7.2** Subjekti, i pyetur nga Komisioni<sup>56</sup> për saktësime në vlerën e deklaruar të kursimeve, shpjegon<sup>57</sup> se: *“Për sa i përket saktësimin të gjendjes cash [...] sqaroj se në deklarinimet e bëra për gjendjet e llogarive/depozitave i jam referuar kryesisht shtesave në llogaritë/depozitë, sipas vitit të deklarinimit, ndërkohë që për gjendjen cash i jam referuar gjendjes reale të tij dhe jo shtesave... Lidhur gjendjen cash kam deklaruar gjendjen e cash dhe jo shtesa. Në vitin 2014 siç ju i referoheni, kam deklaruar: ‘Kursime nga paga ime dhe e bashkëshortes, depozitë pranë BKT-së Tirane dhe cash 400,000 lekë. Në këtë deklarinim kam nënkuptuar kursime në sistemin bankar, si dhe gjendjen cash në vlerën 400,000 lekë... Saktësoj që deklarinimi im në këtë vit përcakton gjendjen cash në shumën 400,000 lekë”*.

Subjekti shpjegon edhe gjendjen cash të çdo fundviti, sipas tabelës në vijim.

**Tabela nr. 9**

Viti	Deklarimi në pyetësin nr. 2
2003 – 2011	Nuk kam deklarinim
2012	Deklaruar vlera 300,000 lekë
2013	Nuk ka ndryshim vlera 300,000 lekë
2014	Deklaruar gjendja në vlerën 400,000 lekë
2015	Deklaruar gjendja në vlerën 400,000 lekë
2016	Deklaruar gjendja në vlerën 600,000

**7.3** Komisioni konstatoi mospërputhje në gjendjen cash në DIPP-në për vitin 2016 (në vlerën 500,000 lekë) me deklaratën *Vetting* (në vlerën 600,000 lekë), për të cilën kërkoi shpjegime nga subjekti, i cili ka shpjeguar se: *“Kjo mospërputhje ka të bëjë me një lapsus në momentin e plotësimit të deklaratës periodike të vitit 2016 me datë 26.3.2017. Gjendja reale cash në datën 31.12.2016 ka qenë në shumën 600,000 lekë, pakësuar në periudhën janar – mars 2017. [...] Në vitin 2016 deklarinim im është: ‘Kursime nga paga ime si prokuror dhe e bashkëshortes, cash 500,000 lekë. Nga kjo shumë 200,000 lekë janë pjesë e pa përdorur e kredisë konsumatore marrë nga bashkëshortja (si staf i BKT-së) me kontratën e datës 17.5.2016. Kam referuar gjendjen cash në banesë. Siç shpjegova më sipër gjendja cash në vitin 2016 duhet të ketë qenë 600,000 lekë dhe jo 500,000”*.

**7.4** Nga hetimi i llogarive bankare të subjektit dhe bashkëshortes, rezulton se subjekti nuk ka pasur mundësi për intervalin kohor 1 janar – 26 janar 2017 (data e plotësimit të deklaratës *Vetting*) të shtojë kursimet cash me shumën 100,000 lekë, pasi tërheqjet totale nga llogaritë bankare rezultojnë në shumën 43,000 lekë.

**7.5** Komisioni, në analizën financiare për periudhën 2003 – 2016, ka marrë në konsideratë deklarinimet periodike vjetore të subjektit, si gjendje kursimesh dhe jo si shtesa apo pakësime.

<sup>56</sup>Pyetësor nr. 2, pyetja nr. 4.

<sup>57</sup>Pyetësor nr. 2, pyetja nr. 6.

**7.6** Komisioni ka konstatuar se ka mospërputhje midis deklarimit të gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting* në shumën 600,000 lekë me gjendjen *cash* të deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 në shumën 500,000 lekë.

Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**7.7** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se kjo mospërputhje ka të bëjë me një lapsus në momentin e plotësimit të deklarimit periodik të vitit 2016 në datën 26.3.2017. Gjendja reale *cash*, në datën 31.12.2016, ka qenë në shumën 600,000 lekë. Duke qenë se formulari i deklarimit periodik për vitin 2016 është plotësuar në muajin mars pas deklarimit *Vetting*, në janar edhe gjendja *cash* është pakësuar, ndërkohë, që është deklaruar në vlerën reale të datës së plotësimit të deklarimit më 23.3.2017 dhe jo gjendjes së datës 31.12.2016.

### **Vlerësim i çështjes nga Komisioni**

**7.8** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme referuar mospërputhjes së gjendjes *cash* të deklaruar prej tij. Gjendja reale *cash* në datën 31.12.2016 ka qenë 600,000 lekë. Duke qenë se formulari i deklarimit periodik për vitin 2016 është plotësuar në muajin mars pas deklarimit *Vetting* në janar dhe gjendja *cash* është pakësuar, ndërkohë, që është deklaruar në vlerën reale të datës së plotësimit të deklarimit më 23.3.2017 dhe jo gjendjes së datës 31.12.2016. Komisioni vëren se nisur nga deklarimi i subjektit ka marrë në konsideratë në analizën financiare gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratat periodike vjetore.

Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe bindëse në lidhje me deklarimin e gjendjes *cash*.

### **8. Gjendje në llogarinë e pagës me nr. \*\*\*, në BKT, datë 24.1.2016**

Vlera: 51,080.25 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

**8.1** BKT-ja konfirmon llogarinë e pagës në emër të subjektit të rivlerësimit me gjendje në datën 24.1.2017, në shumën 51,080.5 lekë.

Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me deklarimin e kësaj depozite.

### **❖ Personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja A.N.**

### **9. Kredia konsumatore në BKT**

Bashkëshortja A.N. ka marrë kredi konsumatore (si staf), sipas kontratës së kredisë, datë 17.5.2016, për blerje automjeti të përdorur dhe rregullim banesë në shumën 924,000 lekë me afat 36-muajor me interes 0.5%. Kësti mujor: 25,862.67 lekë. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer 719,754.86 lekë.

**9.1** Subjekti ka depozituar kontratë kredie, datë 17.5.2016<sup>58</sup>, me kredidhënës BKT-në dhe kredimarrës shtetasen A.N., për kredi në shumën 924,000 lekë, me afat 36-muajor, për blerje automjeti të përdorur dhe rregullim banese, me dorëzanëse shtetasen N.M.

<sup>58</sup>Kontratë kredie bankare konsumatore e datës 17.5.2016.

**9.2** Është administruar përgjigjja e BKT-së<sup>59</sup>, ku konfirmohet disbursimi i kredisë në datën 17.5.2016, në shumën 924,000 lekë, në llogari të bashkëshortes së subjektit. Në datën 18.5.2016 një pjesë e kësaj kredie, konkretisht shuma prej 424,000 lekësh, është kaluar në depozitë, e cila ka qenë aktive deri në datën 7.9.2016, kur është maturuar në shumën 424,090 lekë. Kjo depozitë së bashku me shumën 76,000 lekë të kaluar nga një llogari rrjedhëse e bashkëshortes së subjektit kanë shërbyer për shlyerjen e detyrimit ndaj shtetasit R. T. për blerjen e automjetit në vlerën 500,000 lekë. Pjesa tjetër e kredisë në vlerën 470,000 lekë është tërhequr *cash* nga bashkëshortja e subjektit në datën 30.5.2016.

**9.3** Subjekti është pyetur nga Komisioni për lidhjen e tij me shtetasen N.M. që rezulton si dorëzanëse në kredinë e marrë nga bashkëshortja, për të cilën, gjithashtu, ka shpjeguar se është kolege e bashkëshortes në BKT.

Komisioni nuk ka konstatuar problematika në lidhje me deklarin e kësaj depozite.

#### ❖ KONSTATIME TË TJERA

##### **10. Në lidhje me shumën 200,000 lekë e mbledhur nga lindja e djalit B.N.**

**10.1** Kjo shumë është deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2009 në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale”<sup>60</sup>.

**10.2** Subjekti, i pyetur nga Komisioni të specifikojë dhuruesit dhe burimin e tyre, ka shpjeguar se kanë qenë kryesisht familjarët e tij dhe të bashkëshortes (gjyshër, dajë, teze etj.), si dhe miq të tij dhe bashkëshortes.

**10.3** Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme lidhur me shumën e dhuruara për djalin e tij.

Komisioni nuk ka konstatuar problematika në lidhje me deklarin e kësaj depozite.

##### **11. Në lidhje me depozitën dyemërore në BKT me nr. \*\*\*, në emër të shtetasve A.A. dhe E.K.**

**11.1** Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2007: “*Depozitë bankare e bashkëshortes e krijuar, ndër vite, nga kontributi i saj. Vlera: 1,500,000 lekë. Pjesa takuese: 50%*”.

**11.2** I pyetur nga Komisioni të shpjegojë lidhjen me shtetasin E.K. dhe arsyen e hapjes së kësaj llogarie në dy emra, subjekti ka shpjeguar se ky shtetas është kushëri i bashkëshortes (djali i dajës) dhe qëllimi i përfshirjes së tij në këtë llogari është për arsye aplikimi për studime jashtë Shqipërisë.

**11.3** Nga informacioni bankar ka rezultuar se gjendja e depozitës në datën 31.12.2007 është në shumën 1,300,000 lekë. Bashkëshortja e subjektit, në datë 29.10.2004, ka hapur llogari në BKT<sup>61</sup>, e cila është përdorur kryesisht për transferimin e pagës së saj deri në datën 7.7.2005. Në këtë datë gjendja e llogarisë prej 80,243 lekësh është transferuar në llogarinë<sup>62</sup> dyemërore

---

<sup>59</sup>Përgjigjja me nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2020, nga BKT-ja.

<sup>60</sup>Të ardhura në lekë për djalin B.N., lindur në gusht të vitit 2009, në shumën 200,000 lekë nga të afërm të subjektit dhe bashkëshortes.

<sup>61</sup>Llogari nr. \*\*\*.

<sup>62</sup>Llogaria nr. \*\*\*.

të shtetasve E.K. dhe A.A. Nga kjo datë bashkëshortja e subjektit derdh *cash* ose transferon vlera të cilat kalohen si depozita me afate të ndryshme.

**11.4** Komisioni ka kërkuar nga subjekti të shpjegojë lidhur me burimin shtesë të kësaj depozite, e cila rezulton që për vitin 2007 të jetë në shumën 890,574 lekë, ndërkohë, që të ardhurat e bashkëshortes së subjektit, pa hequr shpenzimet jetike për këtë vit, janë në shumën 702,287 lekë.

Në tabelën në vijim është paraqitur një përmbledhje e ndryshimit të gjendjes së depozitës.

**Tabela nr. 10**

	Gjendja e depozitës/lekë	Shtimi i depozitës/lekë
Gjendja e llogarisë në datën 1.1.2005	10,200	
Gjendja e llogarisë në datën 1.1.2006	453,138	442,938
Gjendja e llogarisë në datën 1.1.2007	1,200,000	746,862
Gjendja e llogarisë në datën 1.1.2008	2,090,574	890,574
Kjo vlerë transferohet në datën 9.12.2008 në llogarinë tjetër (depozite) në emër të saj nr. ***		

**11.5** Gjithashtu, bashkëshortja e subjektit ka llogari dyemërore me shtetasin E.K. edhe në monedhat dollarë dhe euro, të çelura në korrik të vitit 2005. Vlerat në këto llogari janë mbyllur si depozita në valutë dhe ka kryesisht depozitime *cash* të kryera nga bashkëshortja e subjektit.

**11.6** Subjekti, i pyetur nga Komisioni për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të kursimeve të deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 nga bashkëshortja, ka shpjeguar se: *“Kursimet e deklaruar në vitin 2007, janë kursime të krijuara, ndër vite, nga puna e bashkëshortes, si punonjëse e BKT-se që nga viti 2004 e vijim, asistent avokate pranë dhomës së Avokatisë Dibër, pranë shoqatës ‘\*\*\*’ etj. Në vitin 2007 këtyre kursimeve i janë shtuar dhe kursimet tona të përbashkëta. Si burim i krijimit të kursimeve për gjatë vitit 2007 janë të ardhurat nga paga e bashkëshortes si punonjëse pranë BKT -Dega Peshkopi në vlerën 702,287 lekë dhe të ardhurat nga paga ime si prokuror pranë Prokurorisë Dibër në vlerën 1,029,815 lekë. Në këtë kontekst sqaroj se në vitin 2006 kam filluar bashkëjetesën me bashkëshorten dhe në mars të vitit 2007 kemi lidhur edhe martesë ligjore. Në vitin 2006 kemi jetuar bashkë dhe shpenzimet kryesisht janë mbuluar dhe me të ardhurat e mia si prokuror”.*

**11.7** Në vijim të hetimit të llogarive bankare rezulton se depozita e mësipërme në fund të vitit 2008 ka arritur vlerën 2,135,574 lekë. Ndërsa bashkëshortja vazhdon të realizojë edhe në vitin 2009 derdhje në llogari (*cash* - vlera 512,000 lekë dhe transferta), të cilat në datën 5.8.2009, janë në vlerën 3,000,000 lekë, si dhe hap një depozitë 12-mujore. Kjo depozitë maturohet në datën 10.8.2010, në vlerën 3,170,205 lekë dhe kësaj vlere i janë shtuar edhe derdhjet (*cash* dhe/ose transfertë) gjatë kësaj periudhe, të cilat arrijnë në vlerën 3,885,280 lekë, në datën 26.11.2010. Rezultoi se bashkëshortja ka bërë derdhje *cash*, për të cilat nuk njihet burimi i krijimit, në llogarinë e saj në vlerën 512,000 lekë për vitin 2009 dhe në vlerën 1,095,350 lekë për vitin 2010.

**11.7.1** Në datën 15.11.2010, vlera e mësipërme konvertohet në dollarë dhe transferohet në llogarinë e bashkëshortes dhe pas 11 ditësh ( më 26.11.2010) rikonvertohet dhe kthehet në monedhën lekë në këtë llogari. Në datën 6.12.2010 vlera e saj prej 3,629,015 lekësh vendoset në depozitë dhe më 21.1.2011 transferohet në një llogari tjetër në lekë të bashkëshortes dhe, më

pas, konvertohet vlera 3,040,765 në 30,500 USD, e cila mbyllet si depozitë në datën 9.6.2011. Kjo depozitë në datën e maturimit të saj ka shërbyer për shlyerjen e huave të marra ndaj shtetaseve V.H. dhe N.A. (trajtuar në pikën 1.9.3.3-1.9.3.4 më lart).

**11.8** Komisioni, mbështetur në të dhënat e konfirmuara nga vërtetimet bankare, në deklarin në DIPP-në e vitit 2007, si dhe në shpjegimet e subjektit, hartoi analizën financiare të bashkëshortes dhe subjektit të rivlerësimit, për mundësinë e krijimit të depozitës në vitin 2007, e cila është e paraqitur në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 11**

(vlerat në lekë)

<b>Analiza financiare</b>	<b>2006</b>	<b>2007</b>	<b>2008</b>
Të ardhura të bashkëshortes	857 793	702 287	601 236
Shpenzimet jetike të llogaritura për bashkëshorten	109 557	174 072	174 072
Shpenzime udhëtimi të bashkëshortes	150 353	0	3 982
Likuiditete në fillim të vitit	103 749	575 494	1 623 433
Likuiditete në fund të vitit	575 494	1 623 433	2 570 721
<b>Rezultati financiar</b>	<b>126 137</b>	<b>-519 723</b>	<b>-524 106</b>

**11.9** Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

- i) subjekti nuk ka provuar me dokumentacion ligjor të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja, të cilat kanë shërbyer për krijimin e depozitës në shumën 1,500,000 lekë;
- ii) subjekti nuk ka shpjeguar qëllimin e hapjes së llogarisë me dy emra, si dhe nuk provohet qëllimi i përfshirjes së shtetasit E.K. në llogarinë dyemërore;
- iii) nga analiza financiare rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka pasur pamundësi në vlerën 519,723 lekë, për krijimin e depozitës në vitin 2007 dhe pamundësi në vlerën 524,106 lekë për shtesat e vitit 2008.

Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**11.10** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se së bashku me bashkëshorten kanë qenë në bashkëjetesë që në vitin 2006 dhe gjatë vitit 2007. Pra, analiza financiare e kryer nga Komisioni dhe e përcjellë me rezultate duhet të përfshijë edhe të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit. Me marrjen në konsideratë të metodologjisë së mësipërme, subjekti shpjegon se situata financiare përmirësohet duke rezultuar në pozitive për çdo vit gjatë periudhës 2006 – 2010.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**11.11** Komisioni e vlerëson bindës dhe të drejtë shpjegimin dhe kërkesën e subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në analizën financiare të kësaj depozite, të të ardhurave dhe shpenzimeve të tij. Vlera e depozitës është përfshirë në analizën financiare që nga momenti i fillimit të bashkëjetesës me bashkëshorten, duke u bazuar në pyetësonin standard, si dhe

shpjegimeve të qarta në lidhje me kohën e fillimit të bashkëjetesës, të pasqyruara në analizën financiare gjithëpërfshirëse, për vitet 2006 – 2010.

Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë në përputhje me pikën 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka pasur burime të ligjshme për të krijuar likuiditetet në bankë sipas deklarimeve.

## **12. Veprime kreditimi të kryera në llogarinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit**

Komisioni, nga verifikimi i veprimeve bankare, ka konstatuar se janë kryer veprime nga llogaria e bashkëshortes së subjektit në drejtim të personave të tjerë D.M., E.S., B.K. dhe B.L. dhe anasjelltas<sup>63</sup>.

**12.1** Subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime për këto veprime bankare me pyetësonin nr. 2, i cili ka shpjeguar se: *“Lidhur me veprimin, datë 10.4.2006, kredituar llogaria me shumën 100,000 lekë me përshkrimin ‘D.M. kalim në llogari’ sqaroj se shuma prej 100,000 lekësh i është dhënë cash nga ana e bashkëshortes, znj. D.M., e cila në vitin 2006 ka qenë punonjëse e BKT-se në degën Peshkopi së bashku me bashkëshorten”.*

Nga statementi bankar konfirmohet se bashkëshortja e subjektit në datën 11.4.2006 ka mbyllur fondet e depozituara nga znj. D.M. në depozitë 1-mujore.

**12.2** Subjekti shpjegon se: *“Lidhur me veprimin datë 10.9.2010 kredituar llogaria nga E.S. në shumën 100,000 lekë me përshkrimin ‘dhuratë për ditëlindje’ sqaroj se E.S. është kolege e bashkëshortes, ish-punonjëse e BKT-së. Në datën 25.6.2010 nëpërmjet veprimit me referencë \*\*\* bashkëshortja ka kaluar në llogari të znj. S. shumën prej 100,000 lekësh, e cila e ka kthyer këtë shumë me veprimin e mësipërm të kryer nëpërmjet shërbimit internet banking me përshkrimin e mësipërm. Përshkrimi në fjalë nuk ka lidhje me veprimin, pasi në fakt është kthim i shumës 100,000 lekë të kaluar në llogarinë e saj”.*

Nga statementi bankar<sup>64</sup> konfirmohet se në datën 25.6.2010 bashkëshortja ka derdhur cash vlerën 100,000 lekë të transferuar, më pas, te znj. E.S., këto fonde në datën 10.9.2010 janë transferuar prej saj në llogarinë e bashkëshortes.

**12.3** Gjithashtu, subjekti shpjegon se: *“E njëjta situatë është dhe për veprimin e datës 9.12.2011 kredituar llogaria nga E.S. në shumën 170,000 lekë me përshkrimin ‘likuidim detyrimi’. Nga ana e bashkëshortes janë kaluar në llogari të znj. S. shumat 50,000 dhe 120,000 lekë përkatësisht më 28.1.2011 dhe më 1.12.2010, sipas veprimeve me referencë \*\*\* dhe \*\*\*.*

*Rezultoi se nga llogaria \*\*\* bashkëshortja ka transferuar vlerën 120,000 lekë për znj. E.S. në datën 1.12.2010. Gjithashtu, në datën 28.10.2011 ka transferuar shumën 50,000 lekë për dhënie huaje për të. Burimi i shlyerjeve janë fondet e grumbulluara në llogari të bashkëshortes”.*

Në lidhje me derdhjet cash të realizuara nga shtetasi B.K. në vlerë 8,810 USD në llogarinë e bashkëshortes, nga statementi bankar rezulton se bashkëshortja e subjektit A.A. në datën

<sup>63</sup>Në datën 10.4.2006 kredituar llogaria me shumën 100,000 lekë me përshkrimin “D.M. kalim në llogari”; në datën 10.10.2010, kredituar llogaria nga znj. E.S., në shumën 100,000 lekë me përshkrimin “dhuratë për ditëlindje”; në datën 9.12.2011, kredituar llogaria nga znj. E.S., në shumën 170,000 lekë me përshkrimin “likuidim detyrimi”; në datën 24.10.2008 është depozituar cash nga z. B.K., shuma 6,000 USD; në datën 24.10.2008 është depozituar cash nga z. B.K., shuma 910 USD; në datën 28.10.2008 është depozituar cash nga z. B.K., shuma 900 USD; në datën 26.8.2011, dhënie huaje B.Xh.L., shuma 2,568.53 USD.

<sup>64</sup>Llogaria nr. \*\*\*.

30.10.2011 ka tërhequr *cash* të gjithë shumën 8,810 USD të derdhur nga shtetasi B.K. Ndërsa në datën 8.9.2011 është tërhequr *cash* prej saj edhe vlera 2,500 USD e transferuar nga znj. B.L.

**12.4** Në lidhje me këto veprime bankare, subjekti ka shpjeguar se: “*Shtetasi B.K. është kunati im, bashkëshorti i motrës sime. Gjatë vitit 2007 konkretisht në datat 22.2.2007 – 3.9.2007 ka qenë me shërbim në Afganistan, ku dhe është trajtuar në vlerën 60 USD/ dita. Vlera totale e paguar për kohën e qëndrimit në mision është 11.640 USD. Në kushtet kur nuk kishte llogari bankare në BKT dhe kërkonte të hapte një të tillë, ka depozituar shumat e mësipërme në llogarinë e bashkëshortes sime, të cilat më pas janë kaluar në llogarinë e tij*”.

**12.5** Në lidhje me kreditimin e kryer nga shtetasja B.L., subjekti sqaron se: “*...shuma është kredituar prej saj në llogarinë e bashkëshortes sime. Rezulton se shuma e mësipërme është tërhequr dhe kthyer nga bashkëshortja shtetases B.L. në më pak se dy javë*”.

**12.6** Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

i) subjekti i rivlerësimit nuk ka vërtetuar kthimin *cash* të shumës 100,000 lekë shtetases D.M. ashtu sikurse nuk vërtetohet edhe burimi i shumës 100,000 lekë. Rezulton se shuma 100,000 lekë është kaluar në depozitë 1-mujore vetëm pas 1 dite më 11.4.2006 dhe nuk rezulton tërheqje *cash* e shumës;

ii) ka mospërputhje deklarimi nga subjekti i rivlerësimit për shumat në dollarë depozituar nga shtetasi B.K., pasi në pyetësin nr. 2 subjekti deklaroi se shumat e depozituara 6,000, 9,10 dhe 900 USD, që më pas janë kaluar në llogari të shtetasit B.K., ndërsa nga veprimet bankare rezulton që në datën 30.10.2011, bashkëshortja e subjektit A.A. tërheq *cash* të gjithë shumën prej 8810 USD;

iii) është i pakuptueshëm fakti që shtetasi B.K. nuk kishte llogari në dollarë dhe i derdh të gjitha përfitimet në llogari të bashkëshortes së subjektit A.A., ndërkohë, që mund të hapte vetë një llogari bankare;

iv) nuk provohet dhënia e shumës prej 8,810 USD, tërhequr *cash* nga bashkëshortja e subjektit A.A. dhe dhënia e saj shtetasit B.K.;

v) për shtetasen B.L. rezulton nga lëvizjet bankare se nga A.A. është tërhequr shuma 2,500 USD, por nuk provohet kthimi i kësaj shume shtetases B.L.

Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**12.7** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se: “*Lidhur me shtetasen D.M., siç është shpjeguar në pyetësin, shuma prej 100.000 lekësh i është dhënë cash nga bashkëshortja ime A.N., kolege pranë BKT-së dega Peshkopi. Nuk e ka marrë cash bashkëshortja, por ia ka dhënë shtetases D.M. Kjo shumë është tërhequr nga bashkëshortja nga llogaria e saj me NR \*\*\* në datën 24.2.2006 me referencë veprimi \*\*\*, duke ia dhënë cash koleges. Shuma i është dhënë koleges cash pasi znj. M. po blinte valute euro për likuidimin e pagesave të shtëpisë së saj dhe në periudhën e huazimit ka blerë euro me kurs të përshtatshëm*”.

Lidhur me shtetasin B.K., subjekti ka dhënë të njëjtat deklaratime të dhëna në pyetësonin nr. 2 dhe, gjithashtu, shton se: *“B.K., rezulton se ka çelur llogari depozite në dollarë në BKT në datën 9.12.2008 dhe, po në të njëjtën datë, ka depozituar shumën prej 7,810 USD, nëpërmjet veprimit me reference \*\*\* 09-DEC-08 (bashkëlidhur vërtetim nga BKT-ja dega M., datë 16.8.2021). Është pikërisht e njëjta shumë, e njëjta monedhë e marrë cash nga bashkëshortja, të cilën kunati B.K. e ka depozituar në bankë në datën 9.12.2008, nr. llogarinë e krijuar/hapur prej tij”*.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**12.8** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme lidhur me shtetasit D.M. dhe B.K.

Për shtetasen D.M. u provua me deklaratë të lëshuar prej saj se shpjegimet e subjektit ishin në përputhje me vullnetin e shprehur të saj.

Për shtetasin B.K. vërtetohet se nga veprimet bankare në datën 9.12.2008 ka hapur llogari në dollarë dhe, po në të njëjtën ditë, ka depozituar shumën 7,810 USD, pra, pas 2 muajsh të tërheqjes së shumës nga bashkëshortja e subjektit A.L. më 30.10.2008. Pra, periudha e afërt e tërheqjes së kësaj shume nga bashkëshortja e subjektit A.A. dhe depozitimi i saj nga B.K. në llogari të çelur prej tij krijojnë bindjen se është e njëjta shumë që i përket shtetasit B.K. Gjithashtu, subjekti arriti të provojë<sup>65</sup> se vlera e mësipërme e derdhur në llogarinë e bashkëshortes vjen prej shërbimit të shtetasit B.K., në mision në Afganistan për një periudhë 194-ditore, me shpërblim në vlerën 11,640 USD.

Komisioni arrin në konkluzionin se nuk konstatohen problematika lidhur me depozitimet e shumave monetare në llogari të bashkëshortes së subjektit nga personat e tretë.

### **13. Në lidhje me pjesën e bashkëpronësisë së bashkëshortes së subjektit A.A. e 1/3 së apartamentit me sip. 52 m<sup>2</sup>**

Pasuria e sipërcituar ndodhet në lagjen “\*\*\*”, Peshkopi, në bashkëpronësi me prindërit e saj.

**13.1** Komisioni ka konstatuar në llogarinë e bashkëshortes veprimet bankare, pagesa nga shtetasi I.M. kredituar në llogari të znj. A.A. në shumën 600,000 lekë, me përshkrim “për sa kalojmë likuidim për blerje apartamenti sipas kontratës së kredisë nr. \*\*\*, datë 23.4.2013. Po kështu, nga znj. A.A. janë transferuar dy shuma nga 300,000 lekë me përshkrim “1/2 e vlerës së kaluar nga shitja e apartamentit për N.A. dhe Sh.A.”<sup>66</sup>.

**13.2** Në lidhje me këtë situatë, subjekti ka shpjeguar se shtetasi I.M. ka blerë banesën e prindërve të bashkëshortes me një pjesë vlerë të marrë me kredi, ku kjo e fundit ka qenë bashkëpronare me 1/3 pjesë. Në momentin e lëvrimit të kredisë, llogaria e bashkëshortes është kredituar në shumën 600,000 lekë (1/3 e shumës së kredituar nga banka). Subjekti deklaroi se nuk ka pasur dijeni për këtë fakt, pasi është përfutur nga privatizimi kur bashkëshortja ka qenë në shkollë. Duke mos qenë pronare e asnjë pjese të kësaj banese, pa pasur asnjë pretendim

<sup>65</sup>Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2021, nga Komanda e Forcës Tokësore.

<sup>66</sup>Në datën 26.4.2013 I.M.M. ka kredituar llogarinë në shumën 600,000 lekë me përshkrimin “për sa kalojmë likuidim për blerje apartamenti” sipas kontratës së kredisë nr. \*\*\*, datë 23.4.2013; në datën 26.4.2013 A.A. ka transferuar shumën 300,000 lekë me përshkrimin “1/2 e vlerës së kaluar nga shitja e apartamentit për Sh.A.”; në datën 26.4.2013 znj. A.A. ka transferuar shumën 300,000 lekë me përshkrimin “1/2 e vlerës së kaluar nga shitja e ap. për N.A.”.



lidhur me pronësinë, apo kontribut për krijimin e saj, në të njëjtën datë bashkëshortja e subjektit A.N., ka kryer veprimet përkatëse duke kaluar ½ e kësaj shume në llogaritë e secilit prej prindërve të saj.

**13.3** Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit në pyetësonin nr. 2 rezulton se për apartamentin me sip. 52 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Peshkopi në datën 9.5.2011 është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie në emër të shtetasve Sh., N. dhe A.A., me pjesë 33.3% të bashkëpronësisë. Në datën 18.1.2013 është lidhur kontrata premtim shitje nr. \*\*\*, me palë premtues-shitës Sh., N. dhe A.A. dhe palë premtues-blerës I. dhe Dh.M. Ndërsa në datën 8.4.2013 është lidhur kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, me të njëjtat palë. Shitësit janë bashkëpronarë me pjesë të barabarta me 33.3% të apartamentit me sip. 52 m<sup>2</sup> ndodhur në lagjen “\*\*\*”, Peshkopi, të cilët e shesin me çmimin 2,520,000 lekë, shumë kjo e likuiduar nga blerësit jashtë zyrës noteriale. Komisioni konstaton se vlera 1/3 ose 33.3% e shumës 2,520,000 lekë që i përket bashkëshortes së subjektit A.A. është në shumën 840,000 lekë.

**13.4** Komisioni ka hetuar për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit me shtetasit I., Dh. dhe L.M. dhe nga hetimi<sup>67</sup> nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

**13.5** Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

i) në DIPP-të për vitet 2007 – 2013<sup>68</sup>, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit/bashkëshortja nuk ka deklaruar pjesën takuese në bashkëpronësi prej 1/3 pjesë, në apartamentin me sip. 52 m<sup>2</sup> në Peshkopi;

ii) personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit/bashkëshortja nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2013 vlerën prej 840,000 lekësh që i përket 1/3 pjesë të shumës 2,520,000 lekë të apartamentit të shitur në bashkëpronësi me prindërit;

iii) ka mungesë dokumentacioni ligjor që provon faktin se bashkëshortja e subjektit A.A. të ketë hequr dorë nga pjesa e saj e bashkëpronësisë apo t’ia ketë dhuruar pjesën e saj prindërve, ashtu siç ka pretenduar subjekti i rivlerësimit në pyetësonin nr. 2.

Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**13.6** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se është e vërtetë që në DIPP-të për vitet 2007 – 2013, nga bashkëshortja e subjektit nuk është deklaruar pjesë takuese në bashkëpronësi 1/3 për apartamentin me sip. 52 m<sup>2</sup>, në Peshkopi. Një fakt i tillë është mësuar vetëm në vitin 2013 në momentin e shitjes së këtij apartamenti dhe në këto rrethana nuk është deklaruar kjo pasuri në vijimësi në këto vite.

Referuar vlerës 840,000 lekë që i përkon 1/3 pjesë e vlerës totale të shitjes së apartamentit 2,520,000 lekë, kjo shumë nuk është marrë dhe zotëruar asnjëherë nga bashkëshortja e subjektit. Në momentin e lëvrimin të kredisë për shtetasin I.M. llogaria e znj. A.A. është kredituar në shumën 600,000 lekë (1/3 e shumës së kredituar nga banka) në datë 26.4.2013 dhe në po të

<sup>67</sup>Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Dibër dhe Kurbin me nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2021 me nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2021.

<sup>68</sup>Viti 2007 kur subjekti ka deklaruar për herë të parë bashkëshorten në DIPP-në e vitit 2007.

njëten datë prej saj është transferuar në dy shuma (prej 300,000 lekë) në emër të prindërve N. dhe Sh.A.

Lidhur me faktin e heqjes dorë nga pjesa takuese nuk është hartuar ndonjë kontratë apo dokument i mirëfilltë ligjor. Pjesa e bashkëpronësisë nuk është pranuar nga bashkëshortja dhe mënyra e gjetur për të hequr dorë ka qenë kalimi direkt i shumës 600,000 lekë në llogari të secilit prind.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**13.7** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime të plota lidhur me mosdeklarimin nga bashkëshortja e pjesës takuese me 1/3 në bashkëpronësi me prindërit për apartamentin me sip. 52 m<sup>2</sup>, në Peshkopi. Komisioni vëren se në momentin që bashkëshortja e subjektit është vënë në dijeni në vitin 2013, kur ka nënshkruar kontratën e shitjes si bashkëpronare me pjesë takues dhe vlerën përfituese, subjekti i rivlerësimit ose/dhe bashkëshortja e tij kanë pasur detyrimin ta deklarojnë në DIPP-në për vitin 2013 dhe në vijim.

Për sa i përket heqjes dorë nga pjesa takuese e 1/3, Komisioni vëren se bazuar në veprimet bankare është e dukshme që, pasi është bërë kalimi i shumës 600,000 lekë në llogarinë e znj. A.A. nga blerësi, po atë ditë ka bërë transferimin e shumës në 1/2 në llogaritë e prindërve N. dhe Sh.A. Ndërsa diferenca e saj është transferuar në llogaritë bankare të prindërve sipas raportit të bashkëpronësisë.

Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë nuk kanë deklaruar pjesën takuese dhe vlerën respektive të bashkëpronësisë së shtetasës A.A. për apartamentin në Peshkopi, por duke marrë në konsideratë faktin se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë se bashkëshortja e tij nuk ka përfutuar asnjë pjesë të çmimit të përfutuar nga kontrata e shitjes së apartamentit në bashkëpronësi me prindërit e saj, kjo pasaktësi vlerësohet me një peshë minimale, por jo deri në atë masë sa të vlerësohet se plotëson kushtet për aplikimin e pikës 1 të nenit 63, të ligjit nr. 84/2016, për shkarkimin e subjektit nga detyra.

### **❖ Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016**

**14.** Subjektit të rivlerësimit iu kaluar barra e provës për rezultatin e analizës financiare me vlerë negative 3,301,738 lekë.

Ky rezultat financiar vjen si pasojë e: mospërfshirjes në analizën financiare të pagesës së parë të kryer *cash* në shumën prej 10,000 euro; mospërfshirjes të shumave të marra hua nga personat e tjerë të lidhur (nëna e bashkëshortes dhe motra e subjektit të rivlerësimit); mospërfshirjes së depozitës së krijuar nga bashkëshortja dhe subjekti prej fillimit të bashkëjetesës në shumën 1,500,000 lekë; si dhe të veprimeve bankare të kryera nga personave të tretë në llogarinë e bashkëshortes, të cilat nuk u arritën të provoheshin gjatë hetimit të Komisionit.

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe gjatë seancës dëgjimore, shpjegoi duke paraqitur edhe dokumentacion ligjor provues se në lidhje me analizën financiare të hartuar nga Komisioni kishte pasaktësi të cilat janë trajtuar gjerësisht më lart në këtë vendim, të tilla si përfshirja në analizë e vlerës negative prej 519,723 lekësh në vitin 2007 dhe vlerës 524,106 lekë në vitin 2008, si pamundësi krijimi për depozitën e bashkëshortes, kur në këtë analizë nuk ishin marrë në konsideratë edhe të ardhurat e tij, pasi bashkëjetesa kishte filluar prej vitit 2006. Gjithashtu, ky qëndrim duhet mbajtur edhe në vitet 2009-2010 për

analizën financiare të derdhjeve *cash* për depozitën, të realizuara nga bashkëshortja e subjektit në vlerat 512,000 lekë në vitin 2009 dhe 1,095,350 lekë në vitin 2010. Ndërsa në lidhje me derdhjet *cash* të personave të tretë, subjekti i rivlerësimit shpjegon bindshëm dhe me prova se këto derdhje të ndodhura gjatë periudhës 2006 – 2011 janë realizuar nga personeli i BKT-së, në të cilën bashkëshortja ishte e punësuar, për shkak të marrëdhënieve të afërta shoqërore të tyre dhe me qëllim realizim e eficientave ekonomike të transaksioneve të realizuara. Po ashtu, subjekti provon bindshëm se shuma e derdhur në vitin 2008 prej 7,810 USD nga kunati i tij në llogarinë e bashkëshortes ka pasur si burim shërbimin e tij në mision në Afganistan dhe qëllimi ka qenë transferimi i saj në llogarinë e kumatit sapo të hapte një llogari. Për vlerën negative 1,726,866 lekë të vitit 2011 të konstatuar nga Komisioni, subjekti shpjegon në mënyrë shteruese burimet e krijimit të huave të marra nga personat e tjerë të lidhur si nëna e bashkëshortes dhe motra e tij dhe mbi aftësinë financiare të tij për krijimin e vlera të shlyera *cash* për pagesat apartamentin me vlerë 11,000 euro.

Komisioni, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit dhe provat e depozituara prej tij, arriti në konkluzion se ato kanë nivel besueshmërie dhe provueshmërie të mjaftueshëm. Këto vlerësime të Komisionit, të trajtuara gjerësisht më lart, u reflektuan në analizën financiare, për periudhën 2003 – 2016, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka balancë pozitive në vlerën 8,686,252 lekë.

**Tabela nr. 12 – Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016**

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>Të ardhurat</b>	<b>831 911</b>	<b>1 116 273</b>	<b>1 073 439</b>	<b>1 878 480</b>	<b>1 761 185</b>	<b>2 033 534</b>	<b>2 544 652</b>	<b>2 970 885</b>	<b>2 172 958</b>	<b>2 165 323</b>	<b>2 255 478</b>	<b>2 345 962</b>	<b>2 126 209</b>	<b>2 603 847</b>
Të ardhura nga paga e subjektit si Prokuror	831 911	1 116 273	1 073 439	1 014 032	1 029 815	1 196 484	1 422 021	1 602 424	1 067 750	1 072 794	1 108 525	1 280 573	993 832	1 341 678
Të ardhura nga paga e b/shortes pranë BKT	-	-	-	857 793	702 287	601 236	709 709	944 473	1 071 572	1 057 470	1 127 876	1 051 042	1 118 931	1 253 869
Të ardhura nga pensioni i pleqërisë së L*** N***						165 240	148 720	221 760						
Të ardhura për lindjen e djalit Br***	-	-	-	-	-	-	200 000	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga interesi	-	-	-	6 655	29 083	70 574	64 202	202 228	33 636	35 059	19 077	14 347	13 446	8 300
										-	-	-	-	-
<b>Detyrime</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>2 538 120</b>	<b>(95 726)</b>	<b>400 473</b>	<b>(102 571)</b>	<b>(105 536)</b>	<b>637 663</b>
Kredi B*** 2,580,000 lekë dt.26.07.2011									2 538 120	(95 726)	(99 527)	(102 571)	(105 536)	(108 613)
Detyrim shoqërisë M***											500 000			
Kredi B*** 924,000 lekë dt.17.05.2016														746 276
<b>Shpenzime</b>	<b>113 864</b>	<b>113 864</b>	<b>412 843</b>	<b>734 338</b>	<b>410 487</b>	<b>683 308</b>	<b>719 174</b>	<b>845 158</b>	<b>967 302</b>	<b>1 402 538</b>	<b>1 209 597</b>	<b>1 522 917</b>	<b>1 363 365</b>	<b>1 424 007</b>
Shpenzime jetike	93 864	93 864	109 557	219 114	314 487	546 480	603 405	683 100	546 480	564 096	564 096	879 992	897 104	940 368
Shpenzime qiraje	20 000	20 000	60 000	96 000	96 000	96 000	96 000	96 000	96 000	180 000	90 000	-	-	-
Shpenzime mobilimi			133 000	104 000					-	238 000	169 000	270 000	120 000	180 000
Shpenzime interesi kredia 924,000									-	-	-	-	-	2 315
Shpenzime interesi kredia 2,580,000									40 267	86 623	82 922	79 904	68 710	73 427
Shpenzime udhëtimi			110 286	315 224	-	40 828	19 769	15 286	-	21 181	-	-	23 401	-
Shpenzime udhëtimi në funksion të detyrës (2010-2016)								50 772	284 555	312 637	303 578	293 021	254 150	227 897
<b>Pasuri</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>145 703</b>	<b>467 549</b>	<b>1 158 135</b>	<b>937 067</b>	<b>780 179</b>	<b>1 356 745</b>	<b>3 372 247</b>	<b>108 646</b>	<b>1 167 929</b>	<b>130 436</b>	<b>193 669</b>	<b>725 241</b>
Kursime (Shtim/pakwsim likuiditetesh cash + bankë)	-	-	145 703	467 549	1 158 135	937 067	780 179	1 356 745	(4 267 753)	108 646	167 929	130 436	193 669	225 241
Apartament 107.33 m2 +13.8m2 amb. të përbashkëta, Rr "Sh*** K***" F***									7 140 000					
Automjet F*** B*** A***									500 000					
Automjet F*** B***														500 000
Garazh											1 000 000			
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>718 047</b>	<b>1 002 409</b>	<b>514 893</b>	<b>676 594</b>	<b>192 563</b>	<b>413 160</b>	<b>1 045 299</b>	<b>768 982</b>	<b>371 529</b>	<b>558 413</b>	<b>278 425</b>	<b>590 038</b>	<b>463 639</b>	<b>1 092 263</b>

## B. KONTROLLI I FIGURËS

**15.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), pas kërkesës nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021, të Komisionit për rishikim dhe deklasifikim të raportit fillestar, ka dërguar pranë Komisionit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2021, raportin nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Arben Nika, i deklasifikuar plotësisht (me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.3.2021, të KDZH-së) dhe nga Grupi i Punës është konkluduar se: *“Për subjektin e rivlerësimit Arben Nika nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar”*.

Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Arben Nika.

Komisioni konstaton se nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, duke konfirmuar kështu përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Arben Nika.

## C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

**16.** Rivlerësimi profesional sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është i bazuar në raportin e përgatitur nga KLP-ja, si organ ndihmës, dhe kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjet nr. 84/2016<sup>69</sup> dhe nr. 96/2016. Ky organ ka hartuar raportin vlerësues nr. \*\*\* prot., datë 29.6.2021, për subjektin Arben Nika. Në raportin e Komisionit të Vlerësimit në KLP-së për subjektin e rivlerësimit janë evidentuar: (a) aftësitë profesionale<sup>70</sup>; (b) aftësitë organizative<sup>71</sup>; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale<sup>72</sup>; (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional<sup>73</sup>.

<sup>69</sup> “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>70</sup>Ku përfshihen: (a) njohuritë ligjore – subjekti Arben Nika ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit; (b) arsyetimi ligjor – subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor të akteve.

<sup>71</sup>Ku përfshihen: (a) aftësia për të përballuar ngarkesën në punë – rezulton se nga prokurori Arben Nika tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara; (b) aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore – vihet re se qëndrimi i prokurorit në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e tij të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi; (c) aftësia për të administruar dosjet – prokurori ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse.

<sup>72</sup>Ku përfshihen: (a) etika në punë – rezulton se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit; (b) integriteti – nuk ka të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm; (c) paanësia – nuk janë evidentuar raste konflikti interesi apo papajtueshmëri për pjesëmarrje në procedime.

<sup>73</sup>Ku përfshihen: (a) aftësitë e komunikimit – vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit; (b) aftësia për të bashkëpunuar – nuk ka të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë; (c) gatishmëria për t’u angazhuar – subjekti i rivlerësimit rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh pranë dhe jashtë Shkollës së Magjistraturës.

## **Vlerësimi i subjektit të rivlerësimit Arben Nika nga Prokurori i Përgjithshëm**

Subjekti i rivlerësimit Arben Nika, me vendim të Prokurorit të Përgjithshëm, është vlerësuar për punën e kryer prej tij, si dhe për aftësitë profesionale dhe etike: (i) për vitin 2013 është vlerësuar “mirë”; (ii) për vitin 2014 është vlerësuar “mjaftueshëm”; (iii) për vitin 2016 është vlerësuar “shumë mirë”.

Tri dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit:

- konkluzione të diskutimit përfundimtar të gjykimit të procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2012;
- kërkesë për vleftësimin e arrestimit në flagrancë, caktimin e masës së sigurimit dhe për gjykim të drejtpërdrejtë të procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2016; si dhe
- konkluzione përfundimtare lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2014.

Komisioni vëren se bazuar në raportin e KLP-së, si dhe pas administrimit dhe analizës së dokumentacionit në tri dokumentet e mësipërme, nga Komisioni nuk konstatohen problematika që do të mund të sillnin si pasojë ngarkimin me përgjegjësi disiplinore të subjektit në lidhje me kriterin profesional.

### **Pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short**

Dosja 2 – vendim për pushimin e çështjes nr. \*\*\*, të vitit 2014, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Dosja 3 – vendim për pushimin e çështjes nr. \*\*\*, të vitit 2014, akti i datës 26.1.2015, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Dosja 4 – kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2014, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Dosja 5 – kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. \*\*\*, akti i datës 9.2016, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Komisioni vëren se nga Grupi i Punës në KLP, si dhe nga hetimi i kryer nga Komisioni, nuk konstatohen problematika në katër dosjet e mësipërme të përzgjedhura me short, për sa i përket kriterit profesional.

Dosja 1 – vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2013, akti i datës 24.11.2013, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin<sup>74</sup>.

<sup>74</sup>Policia gjyqësore ka marrë informacion mbi bazën e një ankese të paraqitur nga një qytetar. Drejtoria e Inspektimit pranë DPSHTRR-së, bazuar në ankesën e një qytetari, ka kryer kontroll, inspektim në DRSHTRR-në Laç me datë 11.6.2013. Në përfundim të inspektimit në raportin përfundimtar të inspektimit kjo drejtori konstaton se nga ana e shtetases M.Gj. nuk janë arkëtuar në kohë 17 raste të vërtetimeve për humbje patente, në vlerën prej 200 lekësh për vërtetimet e lëshuara. Nga verifikimi rezultoi se gjatë muajit prill të vitit 2013 nuk janë arkëtuar 17 vlera me nga 200 lekë nga vërtetimet e lëshuara (nuk janë prerë fatura) në total 3.400 lekë. Grupi i inspektimit arriti në konkluzionin se punonjësja M.Gj. ka vepruar në kundërshtim me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.7.2010, të MPPT-së mbi aplikimin e tarifës së shërbimit për leje drejtimi dhe për dëmin financiar të shkaktuar në vlerën 3.400 lekë, ngarkohet shtetasja M.Gj. ta shlyejë atë. Pas marrjes së këtij informacioni, policia gjyqësore në rrugë operative nga burim i paidentifikuar datë 23.10.2013, lidhur me veprimet e shtetases M.Gj. për sa u referua më lart, ka filluar kryerjen e veprimeve procedurale. Është pyetur shtetasja M.Gj. lidhur me ngjarjen dhe ka deklaruar se nuk i kujtohen shtetasit që kishin aplikuar dhe për mungesën e arkëtimit të 17 rasteve e ka derdhur këtë shumë pas konstatimit nga auditi. Është pyetur si person që ka konsumuar veprën penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, por nuk ka pranuar të flasë pa avokat. Është administruar raporti final i datës 11.6.2013, nga DPSHTRR-ja (Drejtoria e Inspektimit), janë verifikuar hyrjedaljet e personave që rezultojnë në listën e evidentuar nga grupi i inspektimit nëse kanë qenë prezent vetë kur kanë aplikuar për humbje leje drejtimi, nëse kanë qenë në Shqipëri ato data apo jo. Nga ana e OPGJ-së në datën 23.10.2013 dërgohen materialet hetimore të çështjes dhe në informacionin e referimit të veprës penale sugjerohet fillimi i procedimit penal për veprën penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar në nenin 135 të Kodit Penal në ngarkim të shtetases M.Gj.

Prokuroi Arben Nika ka vendosur: *“Mosfillimin e procedimit penal në lidhje me materialin procedural të regjistruar në Prokurori, kallëzimi nr. \*\*\*, datë 24.10.2013”*. Në tërësinë e akteve të referuara dhe në veprimet hetimore të kryera nuk rezulton të konstatohen elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal apo i ndonjë vepre tjetër penale të parashikuar nga legjislacioni penal. Prokurori ka arsyetuar se veprimet e kësaj shtetaseje gjatë kryerjes së detyrës janë të karakterit administrativ që kanë të bëjnë me arkëtimin në kohë të tarifës së vërtetimeve dhe mënyrën e normimit të kësaj praktike, por nuk mund të trajtohen si elementë të veprës penale, të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, pasi nuk ka asnjë të dhënë që kjo shtetase t'i ketë marrë këto shuma, në total 3,400 lekë, me qëllim për të mos i kthyer apo vjedhur duke shfrytëzuar pozicionin e saj si pranuese dokumentacioni në këtë drejtori.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.1.2020, informon se ndaj vendimit të mosfillimit të kallëzimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2013, nuk është bërë ankim në gjykatë.

Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime hetimore të mëtejshme për të arritur në konkluzionin e mosfillimit të procedimit penal në ngarkim të shtetases M. Gj.

Për konstatimin e mësipërm, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se: *“[...] Veprimet e kryera prej kësaj shtetaseje, gjatë arsyetimit të vendimit të mosfillimit, nga ana ime janë konsideruar si veprime që mund të trajtohen si mospërmbushje e rregullt e detyrës [...] Veprimet e kryera prej saj, mosarkëtimi në kohë i shumës së akumuluar, duket qartë se janë kryer në kushtet e mosnjohjes së udhëzimeve përkatëse dhe jo me dashje, me qëllim moskthimin e tyre.*

*Në këto rrethana, nga ana ime, me vendim të datës 24.11.2013, kam disponuar me vendimin për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin nr. \*\*\*/2013, pasi nuk rezulton të konstatohen elemente të veprës penale të parashikuara nga neni 135 i Kodit Penal dhe as të ndonjë vepre tjetër penale të parashikuar nga legjislacioni penal. Sa i përket konstatimit të relatuar nga ana juaj se nuk janë kryer veprime hetimore për të arritur në konkluzionin e mosfillimit apo regjistrimit penal, sqaroj se rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë hetim të thellë. Në rastin konkret, veprimet dhe verifikimet e kryera nga policia gjyqësore, si dhe administrimi i kopjes së raportit të inspektimit të Drejtorisë së Përgjithshme për rastin nga ana jonë, kanë qenë të mjaftueshme për të konkluduar në vendimmarrjen konkrete për mosfillimin e procedimit penal nga ana ime”*.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime të mëtejshme hetimore, pasi veprimet e kryera nga oficeri i policisë gjyqësore kanë qenë të mjaftueshme për vendimmarrjen, por ndryshe nga sa është referuar nga OPGJ-ja, që ndodhet përpara veprës penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, subjekti ndan një qëndrim të ndryshëm nga ky vlerësim duke i konsideruar veprimet si mospërmbushje e rregullt e detyrës nga e kallëzuara.

**Në përfundim, Komisioni arrin në konkluzionin se ka të bëjë me vlerësim të çështjes që diktohet nga bindja e brendshme e subjektit të rivlerësimit mbi bazën e së cilës Komisioni mban parasysh nenin 72 të ligjit nr. 96/2016.**

## **TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE**

17. Nga Prokuroria e Përgjithshme<sup>75</sup> janë administruar 4 ankesa, nga të cilat një e vitit 2016 dhe tre të vitit 2019, të cilat janë trajtuar nga Prokuroria e Përgjithshme<sup>76</sup> dhe nuk janë konstatuar problematika.

Nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (PPKKKO) është administruar përgjigjja, në të cilën konfirmohet se nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal ndaj subjektit Arben Nika, ndërkohë që është dërguar fashikulli penal nr. \*\*\*, i vitit 2019, ku përmendet emri i subjektit për të cilin është vendosur mosfillimi<sup>77</sup>.

Janë administruar përgjigjet e prokurorive të rretheve gjyqësore<sup>78</sup> që konfirmojnë se subjekti Arben Nika nuk rezulton të ketë qenë person nën hetim apo të ketë procedime penale të pushuara/mosfilluara dhe të pezulluara.

Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë<sup>79</sup> konfirmohet se ndaj subjektit të rivlerësimit Arben Nika janë depozituar 4 kallëzime penale, një i vitit 2016, një i vitit 2018 dhe dy të vitit 2019<sup>80</sup> dhe, pas analizës së fashikujve penalë përkatës nga Komisioni, nuk u konstatuan problematika.

Nga Prokuroria e Përgjithshme<sup>81</sup> është administruar urdhri nr. \*\*\*, datë 17.4.2015, i Prokurorit të Përgjithshëm, ku prokurorit Arben Nika i është dhënë masa disiplinore “ulje në detyrë për 1 vit”, konkretisht kalim në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore për intervalin kohor 21.4.2015 – 21.4.2016, për shkak të zvarritjeve sistematike të hetimeve dhe mospërbushjeve të detyrave, parashikuar nga germa “b”, e nenit 32, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Sipas urdhrin nr. \*\*\*,

---

<sup>75</sup>Sektori i Kontrollit dhe Arkivit me nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2019.

<sup>76</sup>Shihni dosjen profesionale.

<sup>77</sup>Pas veprimeve të tjera hetimore për falsifikimin, bërjen e një aktekspertimi etj., në përfundim PPKKKO-ja ka vendosur “mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. \*\*\*”, datë 11.6.2019”, pasi faktet që lidhen me veprën penale nuk provohet që ekzistojnë.

<sup>78</sup>Prokuroria e Rrethit Gjyqësor: Pogradec nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2020; Sarandë nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2020; Shkodër nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2020; Lushnje nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2020; Mat nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2020; Elbasan nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2020; Vlorë nr. \*\*\* prot., datë 30.4.2020; Fier nr. \*\*\* prot., datë 4.5.2020; Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2020; Krujë nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2020; Durrës nr. \*\*\* prot., prill 2020; Gjirokastrë nr. \*\*\* prot., datë 29.4.2020; Korçë nr. \*\*\* prot., datë 28.4.2020; Pukë nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2020; Dibër nr. \*\*\* prot., datë 28.4.2020; Tropojë nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2020; Kavajë nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2020; Kurbin nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2020; Përmet nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2020; Kukës nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2020; Berat nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2020.

<sup>79</sup>Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë me nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2020.

<sup>80</sup>1. Kallëzimi penal nr. \*\*\*, i vitit 2016 i shtetasve V. dhe D.P. në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Arben Nika (atë kohë ishte me detyrë OPGJ); 2. Kallëzimi penal nr. \*\*\*, i vitit 2019, i shtetas L. Z. në ngarkim të prokurorit Arben Nika dhe gjyqtarës M. Sh., akuzuar për veprën penale “shpërdorim të detyrës”; kallëzimi penal nr. \*\*\*, i vitit 2019, i shtetas L.Z. në ngarkim të subjektit Arben Nika për veprën penale “shpërdorim të detyrës”, referuar procedimit penal, i cili është hetuar më parë po nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë me kallëzimin penal nr. \*\*\*, i vitit 2019, për të cilin u vendos mosfillimi i procedimit penal; \*\*\*, kallëzimi penal nr. \*\*\*, i vitit 2018, i shtetas Xh.J. në ngarkim të subjektit Arben Nika për veprën penale “shpërdorim të detyrës”, pasi prokurori Arben Nika ka vendosur pushimin e çështjes penale për kallëzimin e bërë nga shtetasja Xh.J. për “shkatërrim prone”.

<sup>81</sup>Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit me nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2020.



datë 17.4.2015, të Prokurorit të Përgjithshëm, arsyeja e kësaj mase disiplinore ka qenë kontrolli i ushtruar nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore<sup>82</sup>.

Komisioni ka administruar nga Prokuroria e Përgjithshme<sup>83</sup> praktikën e inspektimit të kryer ndaj subjektit Arben Nika me datë 13.3.2015, ku konstatohet se nga 37 materialet kallëzuese, për 31 prej tyre konstatohet se në dosjet respektive nuk rezulton që të jetë marrë vendim për mosfillim apo regjistrimin e procedimit penal nga prokurori Arben Nika, ndërsa për 6 prej tyre rezulton të jetë marrë vendim për mosfillim të procedimeve penale nga prokurori Arben Nika, të pafirmosur prej tij. Nuk rezulton që të jetë dorëzuar fashikulli te Drejtuesi i Prokurorisë më qëllim kontrolli, arshivimi dhe njoftimi i të interesuarit<sup>84</sup> dhe për 11 procedime penale<sup>85</sup> të regjistruara gjatë viteve të kaluara 2010 – 2013 të caktuara për trajtim prokurorit Arben Nika, nuk janë kryer veprime hetimore, janë lejuar zvarritje dhe nuk është marrë vendim për mënyrën e përfundimit.

Komisioni vëren se lidhur me materialet kallëzuese të lartpërmendura konstatohet se:

**i)** Në hetimin e procedimeve penale objekt kontrolli është konstatuar se janë lejuar zvarritje sistematike dhe nuk janë respektuar kërkesat e neneve 326<sup>86</sup> dhe 327<sup>87</sup> të Kodit të Procedurës Penale për dhënien e zgjidhjeve ligjore (nga prokurori Arben Nika nuk është marrë vendim mosfillimi apo regjistrimi i procedimit penal).

**ii)** Në kundërshtim me nenin 287<sup>88</sup> të Kodit të Procedurës Penale dhe Udhëzimin nr. \*\*\*, datë 21.11.2015, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, prokurori Arben Nika nuk ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit, të cilit i atribuohet vepra penale në regjistrin e procedimeve penale.

**iii)** Nga prokurori Arben Nika janë lejuar zvarritje të paarsyeshme të procedimeve penale<sup>89</sup> në hetim për të cilat prokurori nuk ka marrë vendime për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve.

Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se: “[...] Pa u ndalur në të gjithë materialet kallëzuese dhe procedimet penale të mbartura në veçanti, gjetjet e grupit të inspektimit të Prokurorisë së Përgjithshme janë pranuar nga ana ime tërësisht

<sup>82</sup>Bazuar në urdhrin nr. \*\*\*, datë 23.1.2015, të Prokurorit të Përgjithshëm.

<sup>83</sup>Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 12.7.2021, e Prokurorisë së Përgjithshme.

<sup>84</sup>Shihni materialin bashkangjitur shkresës nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme.

<sup>85</sup>Shihni materialin bashkangjitur shkresës nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme.

<sup>86</sup>Neni 326 i Kodit të Procedurës Penale - Pezullimi i hetimeve 1. Kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm, prokurori vendos pezullimin e hetimeve; 2. Pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme; 3. Hetimi i pezulluar rifillon me vendim të prokurorit.

<sup>87</sup>Neni 327 i Kodit të Procedurës Penale - veprimet e policisë gjyqësore dhe të prokurorit: 1. Pasi kryen veprimet e nevojshme hetimore, policia gjyqësore i dërgon aktet prokurorit bashkë me një relacion shpjegues për faktin dhe provat, si dhe me sugjerimet e veta për mënyrën e përfundimit të hetimeve; 2. Prokurori, pasi shqyrton aktet dhe sigurohet që i pandehuri ose mbrojtësi është njohur me to vendos, sipas rastit, pushimin e çështjes ose dërgimin e saj në gjykatë.

<sup>88</sup>Neni 278 i Kodit të Procedurës Penale - regjistrimi i njoftimit të veprave penale: 1. Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale; 2. Ndalohet publikimi i regjistrimeve të bëra deri në marrjen si të pandehur të personit që i atribuohet vepra penale.

<sup>89</sup>Në 11 procedimet penale të trajtuara më sipër.

pa kundërshtime. Ashtu siç dhe kam shprehur në kohë, mosmarrja e vendimeve në afat për materialet kallëzuese ka ardhur si rrjedhojë e mosvlerësimit në kohën e duhur nën ndikim të rrethanave objektive dhe subjektive të krijuara në atë periudhë kohore (lëvizja, transferimi, larg familjes etj.).

[...] Me gjithë situatën e krijuar, lidhur me materialet kallëzuese 37 prej tyre, nga ana ime pasi ishin studiuar ishte çmuar se nuk ka elemente të veprës penale dhe duhej të ishte vendosur mosfillimi, veprim i cili, vendimmarrje nga ana ime nuk u bë në kohë për sa sqarova më sipër. Pa dashur të justifikoj asnjë veprim timin, gjithë raporti i përgatitur nga ana e Drejtorisë së Inspektimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, është pranuar në tërësi dhe nuk është kontestuar nga ana ime dhe çdo shpjegim apo argument tjetër rreth kësaj situate do të dukej sikur kërkoja të shmangia përgjegjësitë dhe të justifikoja veten, kur me të drejtë edhe pse arsyet që shpjegova më sipër do të duhej t'i kisha kapërcyer. Masa disiplinore e dhënë ndaj meje në përfundim të këtij inspektimi, ka qenë e pranuar dhe nuk e kam kontestuar në gjykatë duke e vlerësuar si të drejtë. Nuk gjej dhe nuk kam argument apo shkak tjetër ligjor për të dhënë lidhur me këtë fakt, përveç sa kam sqaruar edhe në observacionin e kohës. Masa disiplinore e dhënë ndaj meje për shkeljet e kryera rezultoi se është ezauruar/kaluar në periudhën 21.4.2015 - 21.4.2016, duke përbërë tashmë një gjë të gjykuar për të cilën unë e kam marrë një ndëshkim ligjor, referuar ligjit të kohës nr. 8737, datë 12.2.2001, 'Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë'. Sqaroj se në periudhën 2013 – 2016, kjo situatë është ndryshuar dhe ka pasur reagim nga ana ime”.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të njëjta me ato të dhëna përpara Prokurorisë së Përgjithshme kur është njohur me raportin e kontrollit dhe kur iu konstatuan shkeljet e bëra. Subjekti i ka pranuar konstatimet e gjetura nga grupi i kontrollit dhe ato të referuara nga Komisioni në rezultatet e hetimit, duke parashtruar arsyet e tij lidhur me shkeljet e evidentuara në raportin e Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe ka pranuar masën disiplinore pa e kundërshtuar atë në gjykatë. Subjekti thekson se pas masës disiplinore ka ndryshuar sjellje dhe gjithashtu është vlerësuar po “shumë mirë” në vitin 2015 si rezultat i kontrollit të ushtruar nga Prokuroria e Përgjithshme për periudhën kur ka ushtruar detyrën e oficerit të policisë gjyqësore.

Komisioni vëren se masa disiplinore “ulje në detyrë për 1 vit”, konkretisht, kalim në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore në periudhën 21.4.2015 – 21.4.2016, është shuar dhe subjekti është rikthyer në detyrën e prokurorit dhe kjo besohet se ka ardhur për shkak të reflektimit të fortë pozitiv nga ana e tij, e konkretizuar me një performancë të lartë në punë. Kjo përforcohet edhe me faktin se subjekti i rivlerësimit, për vitin 2016, pas shuarjes së masës disiplinore, është vlerësuar “shumë mirë” po nga Prokuroria e Përgjithshme.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi disiplinore për të njëjtat shkelje për të cilat është “ndëshkuar” me masë disiplinore më parë. Komisioni ka analizuar sjelljen e subjektit më pas, duke analizuar me detaje pesë dosjet e hedhura me short të periudhës 2014 – 2016, ku për 4 dosje nuk u konstatuan problematika, ndërsa 1 për të cilën Komisioni i kërkoi shpjegime, subjekti dha shpjegime të mjaftueshme dhe bindëse. Gjithashtu, Komisioni mori dhe analizoi ankesa të bëra në Prokurorinë e Përgjithshme për periudhën 2016

– 2019 dhe, pas verifikimit të tyre, u konstatua se ishin trajtuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe nuk ishin konstatuar që ngarkonin me përgjegjësi disiplinore subjektin e rivlerësimit. Gjithashtu, Komisioni mori në konsideratë edhe kallëzimet penale të bëra në adresë të subjektit të rivlerësimit në periudhën 2016 – 2019, për të cilat është vendosur në favor të subjektit. Komisioni mori në konsideratë edhe denoncimet/ankesat nga publiku të periudhës 2019 – 2020 (të referuar më poshtë) dhe pasi i analizoi me detaje nuk konstatoi problematika lidhur me subjektin Arben Nika, për çështjet të cilat ishin hetuar prej tij.

## DENONCIME NGA PUBLIKU

**18.** Në vlerësimin e kryer ndaj subjektit të rivlerësimit Arben Nika u administruan 12 denoncime/ankesa nga publiku për të cilat pas vlerësimit me objektivitet nga Komisioni nuk u gjetën *indicie* në lidhje me kriterin profesional ndaj subjektit të rivlerësimit<sup>90</sup>.

Komisioni vëren se lidhur me denoncimet e larpërmendura, pas administrimit të dokumentacionit, si dhe pas analizimit të tyre nuk rezultoi të kishte *indicie* apo prova për ta ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore për sa i përket kriterit profesional, referuar pretendimeve të ngritura nga ankuesit/denoncuesit në ankesat e tyre.

Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk mund të konsiderohet me “mangësi” lidhur me kriterin profesional, deri në atë shkallë sa Komisioni të rekomandojë një program trajnimi në Shkollën e Magjistraturës duke vlerësuar se në një vlerësim tërësor të këtij kriteri, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

## KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreu IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Arben Nika:

- a) Ka kryer deklaram të mjaftueshëm dhe në vlerësim tërësor të saktë të pasurisë, duke u konstatuar pasaktësi të karakterit minimal (mosdeklarimi i pjesës takuese dhe i shumës së përfutuar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nga shitja e apartamentit me sip. 52 m<sup>2</sup> në Peshkopi, në bashkëpronësi me prindërit e saj, konsiderohet si pasaktësi me vlerë

---

<sup>90</sup> denoncime të shtetases Xh. J. (nr. \*\*\* prot., datë 5.12.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 16.4.2019; nr. \*\*\* prot., datë 3.10.2019; nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2019; nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2019; nr. \*\*\* prot., datë 9.01.2020; nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2020), të cilat i referohen të njëjtës problematikë të trajtuar në kallëzimin e bërë nga kjo shtetase në Prokurorinë Lezhë; dy denoncime nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 23.12.2020, të shtetases L. Z. dhe denoncim nr. \*\*\* prot., datë 5.4.2019, i shtetasit D. Z. me lëndë “kallëzim penal” për subjektin Arben Nika për veprën penale “shpërdorim të detyrës”; denoncim nr. \*\*\* prot., datë 11.1.2020, i shtetasit F. N. ngre pretendime për korrupsion ndaj subjektit Arben Nika; denoncim nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2020, i shtetasit L. J. dhe D. J. për shkelje të ligjit dhe profesionalizëm të ulët, hetime të paplota dhe të njëanshme nga subjekti; denoncim nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2020, i shtetasit E. S., i cili kundërshton vendimin e mosfillimit të procedimit për çështjen e hetuar nga PPKKKO-ja.

minimale për arsye se subjekti arriti të provojë se bashkëshortja nuk ka investuar në krijimin e kësaj pasurie, si dhe nuk ka përfituar nga shitja e saj).

Nga analiza financiare rezultoi se me të ardhurat e fituara, shpenzimet e kryera, subjekti dhe personi i lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme për të krijuar pasuri dhe për të kryer shpenzimet në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, u provua edhe mundësia financiare për dhënie hua subjektit dhe personave të tjerë të lidhur me subjektin.

- b) Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, kreu V, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Nika, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c) Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Nika, prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 16.9.2021

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Xhensila PINE**

**Kryesuese**

**Olsi KOMICI**  
**Relator**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Olsida Goxhaj*